



HYSNI DAJA

SHTATË KOMISARËT
QË RANË
PËRTEJ KUFIRIT

949.65.088+92

~~Ø 16~~

HYSNI DAJA

5

Ø 14.9

Ø 16

SHTATË KOMISARËT
QË RANË
PËRTEJ KUFIRIT

20939

~~57780~~

BIBLIOTEKA E SHTETIT
GJIROKASTER

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Këtë libër ua kushtoj shokëve që ranë për-
tej kufirit për lavdinë e atdheut me bindje të
plotë se amaneti i tyre për shkatërrimin e fa-
shizmit dhe për çlirimin e popullit do të çohet
deri në fund.

QYTETI I FUNDIT U ÇLIRUA

Pas çlirimit të Lezhës batalioni i dytë i Brigadës VII S i ndiqte gjermanët drejt Shkodrës. Kolona partizane e udhëhequr nga zëvendëskomisari i brigadës, shoku Adil Çarçani, mbërriti në Bushat. I gjithë batalioni filloi sulmin për çlirimin e Shkodrës në vijën Beltojë-Bërdicë. Sulmi ishte aq i befasishtëm sa që shumë gjermanë u gjetën në gjumë; partizanët vranë shumë prej tyre dhe i thyen ata deri brenda në fshat. Në këtë kohë forca të tjera gjermane kundërsulmuan. Partizanët u zmbropsën. Të nesërmen përsëri filloi sulmi mbi këtë vijë. Në qendër të vëmendjes ishte kalaja e Bërdicës e cila qëndronte në mbrojtje të bregut të Bunës dhe urës së Baçallëkut. Sulmi i partizanëve të batalionit të dytë ishte i fortë. Rezistenca e mëtejshme e armikut ishte e kotë. Bombat e dorës u hodhën si breshër mbi kala dhe partizanët duke e sulmuar në krah dhe në shpinë u futën në çadrat e kundërshtarit duke zënë 4 mitralozë, mjaft municion dhe veshmbathje. Për katër orë rresht vazhduan sulmet dhe kundërsulmet; e gjithë lugina ziente. Nga kalaja e Shkodrës artileria e

armikut qëllonte pa pushim, por partizanët me në krye zëvendëskomisarën e brigadës qëndronin heroikisht.

Në këtë kohë edhe në drejtim të Vaut të Dejës, të urës së Mesit e gjetkë buçiste pushka partizane. Armiku kishte krijuar dy-tri vija mbrojtjeje për mbajtjen e qytetit, prandaj duhej patjetër një grupim më i madh forcash dhe një renditje më e mirë. Shtabi i divizionit të dytë dhe Komanda e Përgjithshme afroi forca të tjera. Pas datës 25 nëntor afërsisht ishte kjo renditje forcash: Brigada VI vepronte në Shal-Shosh me një degëzim për të bërë presion mbi vijën Hot-Koplik. Brigada VII kishte marrë urdhër të ngushtohet me vijën Sheldije-Vahu i Dejës-Mjedë duke i lënë vijën Beltojë-Bërdicë Brigadës XXIII dhe XXIV. Brigada XXII dhe grupi i Shkodrës vepronte në verilindje të Shkodrës. Kjo vendosje forcash krijonte kushte dhe më të përshtatshme për çlirimin e qytetit.

Gjermanët kërkonin me çdo kusht që t'i ruanin forcat e tyre të paprekura dhe të krijonin kushte të përshtatshme për tërheqje. Në një raport që ata i kishin drejtuar komandës së tyre thoshin: «Spos-timet vonohen për veprimtari të theksuar bandash në Shqipëri».

Mercenarët shqiptarë për të mos dhënë llogari, kërkonin me çdo mënyrë të largoheshin nga atdheu i tyre. Në mbrëmjen e 25 nëntorit shoku Adil Çarçani kishte të dhëna të sigurta se një varkë me afër 100 mercenarë, nëpërmjet Bunës, do të nisej për në Itali. Për të ndaluar këtë ai i kërkoi shokut Tajar Grepcka 12 partizanë të zgjedhur.

«Mos harroni për çfarë u porosita! — i tha shoku Adil njësitit mbasi i uroi sukses.

«Si urdhëroni, mos kini merak!» — u përgjegj përgjegjësi i njësitit dhe së bashku me shokët u zhduk në errësirën e natës.

Porositë ishin të shkurtëra dhe të qarta: «T'i shmangeshin çdo përpjekjeje me armiqtë e tjerë. Të zihej prita në vendin e këshilluar! Të kapeshin me çdo kusht tradhëtarët!»

Të nesërmen e gjithë brigada u përqëndrua në jugë lindje të Vahut të Dejës. Disa kompani sulmuan kodrën mbi urë që të kapnin disa objekte të përshtatshme për të kaluar lumin.

Gjermanët e kuptuan përgatitjen që po bënin partizanët për sulmin e përgjithshëm prandaj sulmuan me artileri forcat tona. Aty pranë kishës qëndronte më këmbë «Agimi» me disa udhëheqës të tjerë që drejtonin forcat. Predhat e artilerisë plasnin sa lart poshtë, por ata shikonin me kujdes formacionin e partizanëve dhe merrnin masa organizative për sulmin.

Javën e fundit të nëntorit të vitit 1944 kishin rënë shumë shira. Lumenjtë kishin dalë jashtë shtratit të tyre dhe merrnin çfarë të gjenin përpara. Megjithkëtë, me ndihmën e popullsisë vendase dhe sidomos të disa fshatarëve nga katundi Mjedë, me shumë vështirësi, në errësirën e natës, lumi u kalua. Të nesërmen filloi sulmi i përgjithshëm drejt Shkodrës.

Në luginën e Gurit të Zi ndodhet një shkëmb i madh, nga maja e të cilit kontrollohet e gjithë fusha dhe pllaja lindore. Prandaj gjermanët kishin vendosur këtu një mitraloz, i cili, me zjarr të kryqëzuar, mbrohej nga një sistem i tërë qendrash zjarri dhe qëllonte mbi forcat tona.

Partizanët ishin afruar dhe po prisnin urdhërin për t'u hedhur përsëri në sulm.

— Eh, — tha Zihniu, një i ri komunist nga qyteti i Beratit, — pa u asgjësuar mitralozi në majën e shkëmbit nuk mund të ecet përpara! Nga asnjë anë nuk mund të hipet në majën e gurit, madje as granatat nuk mund të hidhen deri atje, prandaj duhet ta izolojmë këtë pikë nga pikat e tjera dhe ta asgjësojmë atë nga afër me zjarr të përpiktë.

Megjithëse për asnjë çast nuk i hiqte sytë nga fusha e luftimit, komandanti dëgjonte me vëmendje propozimin e këtij të riu komunist. Atij, si duket, i pëlqeu ky mendim dhe kjo u vu re nga një buzëqeshje e lehtë që i ndriçoi fytyrën.

— Ku është Faiku? — pyeti komandanti.

Faiku ishte një snajper i mirë; të gjithë qëllonin mirë, por ai qëllonte më mirë në shenjë. Në luftën e Gëziçit në Mirditë batalioni i tretë ishte futur në thellësi të gjermanëve dhe kishte dalë pranë pozicioneve të artilerisë së tyre që qëllonte pa pushim mbi forcat tona. Partizanët dëgjonin dhe shikonin nga larg se të gjitha këto veprime i komandonte në gjuhë të huaj vetëm një oficer. Të gjithë donin të qëllonin kundër këtij kriminelit por një shok propozoi të vinte Faiku. Shpejt e thirrën snajperin e vjetër dhe i treguan objektin. Bateria qëllonte e qëllonte mbi forcat tona. Faiku u shtri sakaq për tokë, mori shenjë, qëlloi vetëm një herë, u ngrit dhe tha me shaka: «U pastë lënë uratën!». Të gjithë panë se si oficeri u shtri sa gjatë gjerë. Grupi partizan sulmoi pozicionet e armikut dhe çau përpara.

Pas pak, pranë komandantit u duk përsëri

snajperi i vjetër dhe së bashku me të rrëshqitën edhe katër partizanë të tjerë. Mbase u afruan buzë xhadesë afërsisht 150 metra ata qëlluan vetëm një herë. Mitralozi për një kohë nuk u ndie më, mirëpo pas pak filloi përsëri të qëllonte. Të pestë snajperët e zgjedhur qëlluan dhe përsëri heshtën.

Partizanët u hodhën në sulm drejt shtëpive dhe me lehtësi shkuan përpara. Brigadat e tjera vazhdonin të ngushtonin rrethimin. Brigada XXII dhe grupi i Shkodrës po rrezikonin prerjen e rrugës Shkodër-Koplik. Brigada XXIII dhe XXIV ju afrua urës së Baçallëkut.

Forcat tona kërkonin me çdo kusht të çlironin qytetin dhe ta shpëtonin atë nga një shkatërrim i sigurt.

Brigada VII vazhdonte të përparonte. Por në të hyrë të fshatit, duke treguar trimëri të rrallë, u vra i riu Zihni Toska.

Më 28 nëntor rrethimi u ngushtua mjaft, sulmet dhe kundërsulmet vazhduan gjatë gjithë ditës që nga kodrat e Bardhajt e deri në Tepe, rrëzë kalasë.

Natën e 29 nëntorit u bë sulmi i fundit i koordinuar nga të gjitha repartet. Gjermanët u tërhoqën nga të dy krahët në panik të plotë, duke ju hequr mundësia për të shkatërruar qytetin. Ata lanë në prapavijë një pjesë të vogël forcash, bashkë me disa fashistë italianë, xhandarë dhe reaksionarë të ndryshëm, të cilët që në pushkët e para hodhën armët. Gjaku i Zihni Toskës i I. Strumit, F. Kaplanit, N. Bejtos, A. Nakos, R. Meçes si dhe i dy partizanëve italianë nuk shkoi kot, por u kurorëzua me çlirimin e qytetit të fundit që shënonte njëkohësisht dhe çlirimin e gjithë Shqipërisë.

Megjithëse në qendër të qytetit u ngrit flammuri kuq e zi përsëri aty-këtu dëgjoheshin të shtëna pushkësh.

Ja, atje te pallacinat, një grup partizanësh çarmatosnin disa fashistë italianë që kundërshtonin të dorëzoheshin. Një grup partizanësh merreshin me çminimin e disa objekteve. Atje, te kafja e madhe, shumë xhandarë e mercenarë pyesnin: «Ku është komandanti? Duam të dorëzohemi!»

Komandanti i batalionit IV, shoku S. Sevrani filloi t'i çarmatoste këta «zotërinj» dhe t'i grumbulloonte në qendër të qytetit. Ai i jepte porosi çdo partizani se si të vepronin. Me dy-tre partizanë ai u drejtua poshtë xhamisë së vjetër, në një pijetore të fshehtë, ku ende disa armiq të popullit po pinin dhe s'kishin ndër mend të dorëzoheshin. Kur komandanti trim në befasi hapi derën, të gjithë shtançën. Dikush e njohu dhe menjëherë ju drejtua: «Urdhëroni të pini, zoti komandant!».

«Lini armët në vend dhe dilni përjashta!» — i urdhëroi ai, ndërsa me duart e tij të sigurt shtrëngonte automatikun e drejtuar drejt tyre. Të gjithë, si pula të lagura, dualën përjashta një nga një. Seiti, që kontrollonte, dalloi midis tyre Refat Pavarin, Gani Zhepovën, Myrto Qafën e të tjerë.

Nga larg një turmë tjetër po afrohej.

Njësitë në bashkëveprim me disa partizanë shkodranë, kishte përmbushur të gjitha porositë e shokut Adil Çarçani, kishte çarmatosur 96 oficerë e mercenarë krerë të «Ballit Kombëtar», ndër të cilët dhe njerëz të «degjenuar» si Bektash Çakrani, Bajram Xeba, Ali Klosi e të tjerë që, me një varkë speciale, ishin nisur për të shkuar në Itali,

por rruga e tyre përfundoi deri në fshatin Belaj, buzë lumit Bunë.

Kaloi mesi i ditës dhe qyteti ende nuk ishte qetësuar.

Populli, pa pushuar mirë krismat e armëve, filloi të dalë në rrugë, duke brohoritur për Partinë Komuniste, për shokun Enver Hoxha, për Stalinin e madh, për partizanët tanë trima.

Shokët e partisë dhe të pushtetit organizuan një parakalim të partizanëve që shënonte fitoren përfundimtare mbi armikun.

Partizanët të veshur keq, por me një hap të sigurt dhe energjik, kaluan krenarë përpara popullit dhe komandës së Divizionit II.

Populli shikonte, buzëqeshte dhe u hidhte lule partizanëve që kishin luftuar për çështjen e popullit, për çlirimin e atdheut.

Pastaj kaloi e çarmatosur dhe kokulur ushtria e mundur, aty kishte oficerë dhe «ksponentë të «Ballit», të «Legalitetit» dhe reaksionarë të çdo ngjyre e të çdo kallëpi që arrinin në më tepër se 1000 vetë.

Me syrin e urrejtjes, të përbuzjes dhe të hakmarrjes i shikonte populli këto fytyra të urreyera që u shërbyen armiqve deri ditën e fundit.

Në mitingun e organizuar me rastin e kësaj dite të shënuar komisar i foli për luftën e popullit tonë për çlirimin e atdheut, për sakrificat e partizanëve, për dëshmorët e rënë në luftë, për luftën e aleatëve tanë dhe për detyrat tona.

Midis të tjerave komisar i njoftoi urdhërin e Komandantit të Përgjithshëm, shokut Enver Hoxha, për të ndjekur armikun përtej kufijve. Ai tha se «lufta jonë është një luftë e drejtë dhe kemi detyra

internacionaliste për çështjen e përbashkët, për shkatërrimin e fashizmit dhe për të ndihmuar popujt e tjerë. Prandaj, — tha komisari, — me çlirimin e Shqipërisë detyra jonë nuk ka mbaruar, armikun do ta ndjekim dhe përtej kufijve, deri në strofkën e tij të fundit».

«Deri në Berlin!» — buçiti zëri i partizanëve. Kjo ishte dëshira e të gjithë të pranishmëve, të cilët, duke ngritur grushtin lart, brohorisnin fort për Partinë Komuniste, për shokun Enver.

Partizanët ishin shumë të gëzuar që do të vazhdonin luftën përtej kufirit. Mbas hëngrën bukë aty, te kazernat e vjetra, të gjithë u shpërndanë. Në çdo batalion dhe kompani filluan mbledhjet e celulave të partisë, të organizatave të rinisë. Komisarët folën për situatën e brendshme dhe të jashtme, për detyrat që dilnin përpara për të vazhduar luftën. Të gjithë ishin optimistë për fitoren përfundimtare dhe me këngë në gojë u nisën drejt Veriut, drejt kufirit.

PARTIZANI MALAZEZ

— Mbërritëm në anën tënde, o Nikollë, — i thotë partizani i vogël me shaka, komandantit të skuadrës automatikase.

— Po, — tha Nikolla, — por t'i nuk e di vendin këtej? Ne kemi gjysmë ore që kemi kaluar kufirin, tani është luftë dhe në kufi nuk ka roje.

Partizani i vogël i shkante gjithmonë mbrapa Nikollës. Duke vazhduar muhabetin rruga gjithmonë kalohej më lehtë. Bënte shumë ftohtë, dalëngadalë nata po ja linte vendin agimit dhe së largu dalloheshin kodra, male, gërxhe e fshatra. Ja, atje poshtë në majën e një kodre dëgjoheshin të shtëna pushkësh, bomba dhe gjëmimi i artilerisë së armikut.

— Ti e njeh mirë vendin këtej Nikollë, pa na trego ku jemi? Si quhet ai vend ku po bëhet luftë? Po ky lumë dhe këto fshatra përreth si quhen? Po fshati yt ku është? — shpërtheu një breshëri pyetjesh partizani i vogël.

Nikolla ishte malazez. Ai kishte ikur qysh në kohën e Zogut prej Malit të Zi dhe ishte vendosur në periferi të Beratit. Kishte një histori të gjatë.

Historia e tij ishte historia e të gjithë atyre që persekutoheshin përtej kufirit.

Me fillimin e Luftës nacionalçlirimtare Nikolla u rreshtua në radhët e partizanëve, në fillim në grupin e Skraparit dhe pastaj në batalionin II të Brigadës VII sulmuese si partizan dhe pastaj si komandant i skuadrës automatikëse. Ai ishte rreth 33 vjeç, por vuajtjet dhe rudhat e tregonin aq plak sa që partizani i vogël shumë herë e thërriste xha Nikollë, madje e krahasonte edhe me xha Rakon, partizanin më plak të brigadës.

Nikolla ishte endur për vite me radhë për të drejtën e tij, për tokën, për bukën, por gjithmonë jetonte pa shpresë. E vetmja shpresë e tij u bë partia, e cila u çeli rrugën fukarenjve. Dhe Nikolla u hodh pa rezerva në luftë. Ai i ra përçark disa herë Skraparit, shkoi në Berat, në Shpirag, në Dumre e Myzeqe, ku pa me sytë e tij bujkun e robëruar, ekonominë e tij të shkatërruar dhe luftoi për çlirimin e këtij bujku.

Në luftë ishte i papërmbajtur. «Do të luftoj, — thoshte Nikolla, — sa të mos ketë më «krajla».

Kur xhandarët e Xhafer Devës së bashku me gjermanët ndërmorën një sulm kundër partizanëve, në Qafën e Sqepurit në afërsi të qytetit të Beratit, Nikolla që i pari që u sul mbi ta. Me plumbat e tij ai rrëzoi për tokë edhe nëntogerin e xhandarmërisë. U dallua në luftimet për çlirimin e Beratit dhe sidomos në luftën për çlirimin e Shënpalit të Mirditës. Më parë ai kishte një mashinë angleze, por në Shënpal mori një automatik gjerman, të cilin s'e lëshoi nga dora deri ditën e fundit.

Nikolla rrallë fliste, ishte tip serioz, por herë pas here këmbente edhe ndonjë shaka; më tepër

këto shaka i bënte me partizanin e vogël, për të cilin kishte një dashuri të madhe. Ai çmonte trimërinë, urtësinë dhe respektin e këtij të riu që nuk kursehej për asgjë, as për shokët e tij. Dhe ky i ri tani, me të kaluar kufirin, shpërtheu me gjithë ato pyetje.

— Ja, — tha Nikolla duke treguar, — kjo është maja e Tuzit. Në atë luginë ku mjegulla është më e dendur është Podgorica, lumi që kemi përpara është lumi i Cemit, i cili buron nga malet e Kelmendit nga Selca, mbasi kalon kufirin bashkohet me lumin Moraça e derdhet përsëri në Liqenin e Shkodrës. Uji i tij është mjaft i kulluar.

— Nëma ta mbush paguren, o xha Nikollë, — i tha partizani, — se ndoshta nuk do të takojmë më ujë të tillë.

Partizani i vogël, mbasi mbushi paguren, hyri përsëri në rresht.

Filluan të marshonin në të përpjetë. Kthesat sa vënin e bëheshin më të shpeshta dhe partizani i vogël ndoshta nga lodhja apo nga pagjumësia harroi se Nikolla nuk ju ishte përgjegjur të gjitha pyetjeve.

Kur dolën në krye të së përpjetës Nikolla i tha partizanit të vogël:

— E, more picirruk, u lodhe?

— Jo, — u përgjegj djaloshi.

— Ja, — tha Nikolla dhe filloi përsëri të flasë me partizanin e vogël, — ky katundi këtu afër quhet Muzhecka. kurse ai më në veri, matanë asaj kodre quhet Koritë. ai atje larg në drejtimin që shkoimë ne, quhet Kuç, fshati që lamë quhet Skoraç, ndërsa ky që kemi përballë quhet Rudinë...

«Pushim» — u dëgjua zëri i komandantit dhe,

sipas rregullave, të gjithë qëndruan të pushonin në vendet e tyre. Vetëm Nikolla me partizanin e vogël qëndronin aty në krye të kolonës jo shumë larg komisarit.

E shikon atë pyllin atje larg mbi Koritë? — tha Nikolla. — Sa herë kam kaluar fshehtazj kufirin, sa herë e kam bërë këtë rrugë, sa herë jam endur këtyre shkrepave, sepse na ndiqnin këlyshët e krajlit, të cilët ndiqnin ata që nuk i nënshtroheshin vullnetit të tyre, ata që ruanin traditat dhe zakonet shqiptare.

Komisari dëgjonte me vëmendje dhe thithte cigaren që e kishte ndezur së bashku me shokun që kishte pranë.

— Unë. — tha Nikolla, — luftova dhe e pashë Shqipërinë të çliruar. Megjithatë unë do të vazhdoj të luftoj deri në zhdukjen e plotë të fashizmit, derisa të mos ketë më bejlerë dhe agallarë, dhe popujt të mos jetojnë të përçarë. Unë, megjithëse jam këtej kufirit dhe fshati im është ende shumë larg, prapë e quaj veten shqiptar, sepse edhe prejardhja jonë e tillë është.

— Dhe tamam si shqiptar ke luftuar, o Nikollë! — e ndërpreu partizani i vogël.

— Është e vërtetë që Nikolla në shumë luftime në Jug e në Veri është treguar trim dhe guximtar dhe ne kemi respekt për të, — tha komisar.

— Unë nuk kam bërë gjë tjetër përveç detyrës sime, — tha Nikolla. — Nuk e di nëse do të mbërrij në fshatin tim të lindjes, por po të arrij do t'i tregoj të gjitha ato që kam mësuar në Shqipëri, si kemi luftuar së bashku, si kemi ndarë kafshatën e bukës për gjysmë dhe sa ka vuajtur populli për çlirimin e vendit. Unë isha një që më ra rasti të

ndihmoj në luftë për çlirimin e Shqipërisë, por ju jeni me mijëra që po shkoni në luftë për të ndihmuar vëllezërit tuaj, shokët tuaj përtej kufirit.

Përsëri filloi marshimi, por biseda nuk u ndërpre. Rruga shkonte gjatë pllajës së katundit Selitë. Aty më tutje, nga një qafë dukeshin kodrat e ashpëra dhe të thepisura të Malit të Zi, që sa vinin e zbrisnin deri poshtë në fushë.

— Po ajo majë atje larg — vazhdoi përsëri partizani i vogël, — cila është?

— Ajo është kalaja e Medunit, — u përgjegj Nikolla.

Komisari ndaloi, pa me vëmendje atë kala që ishte aq larg dhe që së shpejti do ta sulmonin forcat tona.

Një breshëri artilerie ndërpreu bisedën midis partizanit të vogël dhe Nikollës.

«Kthehuni djathtas!» — u dëgjua zëri i komandantit. — «Kaloni mbas dy shtëpive!».

Ne e lamë rrugën dhe kaluam në anën tjetër të shtëpive në rrugë pa rrugë, vazhduam marshimin derisa mbërritëm në katundin Kuç dhe dolëm përpara kalasë së Medunit.

Më datën 12.12.1944 dy batalione të Brigadës VII sulmuese sulmuan kalanë e Medunit dhe kodrat përreth saj. Gjermanët, të detyruar nga zjarri i përpiktë dhe manevra krahëmarrëse dhe shpinëmarrëse e partizanëve tanë, u tërhoqën duke lënë 16 të vrarë e 7 të plagosur.¹⁾

Sulmet vazhduan për disa ditë me radhë, poshtë Medunit, në drejtim të kodrave të Kosorrit dhe të

1) Arkivi Qendror i Ushtrisë, Fondi Brigada VII, Dosja Nr. 1.

Zlaticës. Partizanët kudo tregonin trimëri të rrallë. Partizanët e Brigadës VII sulmuese pothuajse zotëronin të gjithë luginën e Medunit dhe krejt xhadenë që të çonte në Podgrad.

Nikolla bënte çmos që të gjente sadopak ushqim për partizanët shqiptarë. Atij nuk i vinte mirë që ne vuanim për mungesë ushqimesh. Diku gjente pak bukë thekre, diku pak patate dhe diku pak oshafë, të cilat ua sillte partizanëve.

Para dite një batalion jugosllav sulmoi kodrat lindore të Zlaticës. Vrojtuesit tanë vëzhgonin nga larg veprimet e tyre. Ata sulmuan drejtpërdrejt ndoshta që të hynin të parët në katundin Dolan dhe në qytetin e Podgoricës, por sulmi i tyre nuk pati sukses. Ata u larguan dhe brigadat shqiptare dolën me luftë në vijën Bioç-Dolan-Podgoricë-Tuz.

Nikolla i kërkoi leje komisarit që të sulmonte kodrën nga krahu i djathtë dhe ta merrte me skuadrën e tij këtë objekt të rëndësishëm. Por komisar i nuk e lejoi.

— Jo, Nikollë, — i tha ai, — ne do të hidhemi në sulm në mbrëmje. Kemi katër ditë që po sulmojmë dhe nuk do ta ndalim sulmin tonë pa i larë hesapet me gjermanët, pa hyrë në Podgoricë dhe Bioç.

Gjatë ditës Nikolla e pregatiti skuadrën për sulm. Me të rënë muzgu i mbrëmjes kompanitë rrëshqitën përbri njëra-tjetrës drejt kodrave të Kossorit, Zlaticës dhe Sejnicës. Në orën 20 të gjitha batalionet, duke përdorur gjerësisht manevrën u hodhën në sulm. U ndez një luftë e ashpër. Gjermanët rezistonin me këmbëngulje.

Partizanët nën errësirën e mbrëmjes u afruan në distancën e hedhjes së granatave dhe, duke

thirrur «përpara partizanë», nga shumë drejtime, hynë në llogoret e kundërshtarit.

Në drejtimin kryesor ku vepronte Brigada VII luftimi arriti gati trup me trup. Aty u vranë partizanët Veri Tego, Lame Viko dhe Llambi Ciko dhe u plagosën disa të tjerë.

Në krahun e majtë sulmonte përpara vetë komandanti i batalionit shoku Mitat Luçi, i cili u plagos në vijën e parë. Ky komandant që kishte kryer shumë atentate, shumë luftime dhe që kishte marrë mjaft plagë u bë shembull qëndrese për të gjithë të tjerët.

Kompanisë II i takoi një objekt me shumë rëndësi. Nikolla me skuadrën e tij automatikëse u fut thellë në formacionin e armikut dhe gati u preu rrugën gjermanëve. Kur panë gjermanët se po rrezikoheshin, organizuan në këtë drejtim një kundërsulm të fortë. Në këtë duel të shkurtër dhe gati trup me trup u vra partizani Gjergj Goga dhe u plagos rëndë Nikolla.

Shokët e muarën Nikollën dhe e tërhoqën deri në Qafë të Shkëmbit të Bardhë te një shtëpi e veçantë. Ai vazhdonte të thërriste tërë rrugës: «Përpara partizanë!» «Mos i lini të ikin!», por sa vinte dhe forcat po i mbaroheshin.

Në kohën kur po jepte shpirt aty përpara duarve të shokëve të tij ai tha: «Ma bëni hallall shokë. Të rrojë Partia Komuniste Shqiptare! Unë nuk arrita dot ta shikoja fshatin tim, të afërmit e mi, të shikoja edhe unë lirinë pa bejlerë e agallarë, pa «krajla», por ju do ta shikoni këtë me siguri».

Ai vdiq, por forcat tona kaluan përsëri në sulm dhe i përmbushën me nder të gjitha detyrat e ngarkuara nga partia dhe shoku Enver.

ANGLEZËT

Të gjitha batalionet po përgatiteshin për sulmin e mbrëmjes. Në kodrat e Kosorrit, të Cvarinit dhe në majat shkëmbore midis qendrave të banuara Medun dhe Dolan ndodheshin reparte ushtarake. Gjermanët mbanin me këmbëngulje kodrat e përgatitura për mbrojtje në lindje të lumit Moraça.

Në Veri ecte me shpejtësi një repart jugosllav, i cili u kishte lënë vendin reparteve tona dhe në bazë të urdhërit të Korpusit III¹⁾ do të kalonte në drejtim të Veriut, pasi në këto anë do të vepronte vetëm Divizioni VI shqiptar, i cili ishte vendosur nga Tuzi e deri në Verushë.

Në mbrëmje e gjithë Brigada VII do të sulmonte. Ja, aty afër qëndronte komisar i batalionit I, i cili vështronte partizanët e dy kompanive të batalionit fqinj që me shpejtësi po ecnin nga kisha e Medunit në drejtim të kodrave të Kosorrit.

— Shikoni, shikoni! — tha Rizai. Të gjithë

1) Arkivi Qendror i Ushtrisë, Fondi Divizioni VI, Dosje Nr. 1.

kthyen kokën dhe panë se dy aeroplanë po fluturonin me shpejtësi drejt nesh. «Aleatët tanë.» — tha dikush. «Anglezët» — tha tjetri.

Anglezët thonin se kishin dalë në Adriatik madje deri në deltën e Nusentës dhe se bateritë dhe aeroplanët e tyre bombardonin gjermanët pa pushim.

— A është e vërtetë shoku komisar se anglezët bombardojnë gjermanët? — pyeti Jashari, një partizan që gjithmonë veprimet e anglezëve i vinte në dyshim.

Një herë Jashari kishte shoqëruar një oficer anglez për në Shtabin e Përgjithshëm. Oficeri gjatë rrugës kishte ngrënë konserva e çokollata dhe atij nuk i kishte dhënë asnjë gjë. Jashari thoshte se ata ishin të pabesë, se ata s'ishin aleatë dhe gjithmonë pyeste komisarin mbi qëndrimin e tyre. Komisari i kishte shpjeguar me durim se aleatët tanë ishin shumë dhe në radhë të parë aleati ynë, i kishte thënë ai, ishte Bashkimi Sovjetik, i cili mbante peshën kryesore në luftë. Ai i kishte folur gjatë edhe për anglezët, për amerikanët, edhe përse ata e kishin vonuar hapjen e Frontit të dytë, i kishte treguar qëllimin e tyre për ndërhyrje kudo, me punë e pa punë. Por tani Jashari po shikonte një gjë tjetër. Aeroplanët anglezë, mbasi u vërtitën mbi kokat e partizanëve, fluturuan deri larg dhe, mbasi u kthyen, filluan të uleshin. Me të mbërritur në krye të kolonës së partizanëve të batalionit II, ata filluan të mitralonin.

Rrafshi vertikal i qitjes kaloi tre metra majtas kolonës. Atje ku kolona bënte kthesë u plagosën dy partizanë, nga të cilët njëri vdiq më vonë.

— Të poshtërit! — tha komisari dhe menjëherë ktheu automatikun kundrejt tyre.

— Të kam thënë, o komisar, të tillë janë! — tha Jashari dhe u mbështet me belzhik mbi një shpellë. Sakaq aeroplanët u larguan në drejtim të perëndimit, duke lënë mbrapa vetëm zhurmën e tyre monotone.

Kodra në veriperëndim të Medunit ishte një kodër e madhe. Ajo midis kishte një gropë. (Shumë kodra e gërxe në Mal të Zi kanë gropa të tilla që vendasit i përdorin për të mbjellë patate). Në mes të kësaj grope qëndronin shumë partizanë dhe po bisedonin për skenën që panë. Aty erdhi dhe komandanti.

— A i pe aleatët, shoku komandant? — tha Jashari me të qeshur.

— I pashë, — tha komandanti dhe u ul pranë komisarit.

— A të kujtohen ata anglezët e Rubikut? — e pyeti komisar.

— Po, — tha komandanti, — më kujtohen edhe ata shumë të liq ishin!

Partizanët dëgjonin me vëmendje. Njëzet e katër anglezë ishin me Bazin e Canit dhe me të tjerë mercenarë. Kur panë që Bazi i Canit dhe shokët e tij i kishin këmbët më të lehta se të anglezëve dhe që ata ja mbathën për të shpëtuar kokën e tyre, atëherë anglezët, të mbetur vetëm, u dorëzuan. Ua bëri mirë batalioni III që i futi në arrest!

— Eh, — tha komisari — për atë hëngrëm dhe një vërejtje!

— Por unë, — tha Jashari, — mendoja se janë të tjerë ata anglezë që janë në Frontin Nacional-çlirimtar dhe të tjerë ata anglezë që janë me Bazin

e Canit. Nuk mendoja se të gjithë një lëkurë kanë.

— Po shefi i seksionit politik si i tha përgjegjësit të tyre në Rubik? — pyeti komandanti (mbasi kur kishte ndodhur kjo çështje ai s'ishte atje).

Kur i zunë anglezët e Rubikut ata thanë se nuk ishin me Bazin e Canit, por me të gjithë ata që ishin në luftë kundër fashizmit. Por radiostacionet dhe dokumentat e tjera tregonin se ata kishin ndër mend të zbarkonin në Shëngjin-Bregu i Matës. Me daljen e brigadave tona në Zadrimë, me shpartallimin e gjermanëve e të bajraktarëve në atë anë dhe në saje të vigjilencës së lartë të partisë sonë, planet e tyre dështuan.

Një krismë shumë e fortë e pasuar me një zhurmë shurdhuese u dëgjua në drejtim të qytetit Podgoricë. Të gjithë muarën armët dhe vrapuan drejt kodrës që s'ishte më larg se dhjetë metra.

— Aeroplanët bombardojnë Podgoricën — tha roja.

Një skuadrilje e tërë bombardonte qytetin.

Gjermanët qëndronin ndër pozicione, përballë nesh dhe bateritë e tyre herëpashere qëllonin forcat tona.

Partizanët vështronin nga larg qytetin që bombardohej ende nga aeroplanët anglezë. Bombardimi vazhdoi edhe të nesërmen, derisa qyteti u rrafshua i tëri.

Krismat e forta vazhdonin të dëgjoheshin, shtëllungat e tymit të zi ngriheshin deri lart; aeroplanët përsëri vërtiteshin dhe përsëri bombardonin.

Komisari, komandanti dhe shokët e tjerë qëndronin pranë njëri-tjetrit, rrëzë atyre shpellave në majën e kodrës. Në këtë kohë të shtëna të tjera të artilerisë gjermane u dëgjuan, predhat e tyre

sa vinin dhe afroheshin dhe ja, një predhë plasi afër tyre.

— Shtrihuni! — tha komisari.

Të gjithë u zvarritën mbrapa shpellave derisa armiku filloi të qëllojë një kodër më në thellësi. Jashari ishte gjakosur në krah nga një copë predhë dhe shokët vazhdonin t'ja lidhnin atë plagë të parëndësishme. Komisari ju afrua, e pa Jasharin dhe i tha: — E, Jashar, anglezët po bombardojnë gjermanët!

— I pashë, shoku komisar se ku bombardojnë anglezët, — u përgjegj Jashari. Çdo gjë u bë e qartë. Po të qenë të mirë ata, pse nuk bombardojnë kodrën e madhe mbi qytetin e Podgoricës, pse nuk bombardojnë bateritë e artilerisë gjermane që ndodhen këtu poshtë në Fushën e Dolanit, kolonat e tyre në luginën e Moraçës ose pozicionet përballë nesh, por bombardojnë qytetin atje ku nuk ka gjermanë, ose bëjnë ndonjë mitralim të thjeshtë pa i dalluar në se janë gjermanë, shqiptarë apo jugosllavë.

Komisari vazhdoi përsëri të fliste për qëndrimin e tyre. Ai tha se së shpejti ne do të takohemi me aleatët e vërtetë, me sovjetikët, të cilët kanë dalë në portat verilindore të Ballkanit dhe së shpejti ne do të radhitemi për krah tyre.

— Sa për anglo-amerikanët, — tha ai, — atyre me të vërtetë u doli boja fare, ata e zgjatën hapjen e Frontit të dytë sa nuk mbante më dhe e hapën vetëm atëhere, kur e panë dhe kur u bindën se Bashkimi Sovjetik dhe popujt e tjerë përparimtarë mund ta fitonin luftën edhe vetëm. Ata përsëri kërkojnë tani që Bashkimi Sovjetik dhe popujt e

tjerë të dalin nga kjo luftë sa më të dobët. Prandaj ata bombardojnë qytetin. Por kjo luftë e zgjoi njerëzimin. Ata shohin me sytë e tyre se kush janë miqtë dhe aleatët e tyre dhe kush janë armiqtë.

* * *

Kur forcat tona hynë në Podgoricë, ne pamë rrënimet e mëdha që ishin bërë: shtëpi të shkatërruara, rrugë të prishura, dyqane të djegura, pasuri të grabitura.

Megjithatë shumica e vendasve ishin larguar me kohë, ende mund të shihje disa njerëz, të cilët ishin mbuluar së bashku me drurët, gurët dhe qerpiçët e rrënuar. Nuk dallonim dot se ku ishte qendra e qytetit, aq ishte rrënuar! Madje ne nuk kishim parë gropa predhash aq të mëdha sa gropat që ishin hapur nga plasjet e bombave të avionit anglez në këtë qytet.

Ja këta ishin anglezët, «aleatët tanë»!

SKËNDER LIBOHOVA

Porsa doli nga mbledhja e një celule, komisar i batalionit I, i shoqëruar nga dy partizanë, me shpejtësi u drejtua për në kodrën e fundit të katurndit. Aty e prisnin komandantë dhe komisarë të tjerë, të cilët vazhdonin të grumbulloheshin atë mbasditë në atë kodër të lartë.

Komisari i batalionit pa mbërritur në kodër, në një ledh, afër disa arave takoi disa partizanë. Si zakonisht ai i përshëndeti dhe i pyeti në se ishin gati për sulmin e mbrëmjes.

— Të gjithë gati, shoku komisar! — u përgjegjën partizanët njëzëri. Komisar i u ndal pranë Muharremit, i cili ishte i sëmurë. Muharremi njihesh prej kohësh me Skënderin; ata dikur kishin qenë në një kompani dhe kurdoherë rrinin e sulmonin së bashku.

— Si e ndjen veten, Muharrem, a je më mirë? — e pyeti komisar.

— Më mirë jam, shoku komisar, — duhet të jem ftohur, por s'ka gjë, unë do të ngrihem dhe



Dëshmori Skënder Libohova.

përsëri do të sulmojmë së bashku si atëhere në Berat e në Gëziq.

— Jo! — tha komisari dhe ju drejtua komandantit të kompanisë: — Muharremin duhet ta strehoni në ndonjë shtëpi, ose së paku të rrijë me ndonjë shok pranë zjarrit. Pastaj ai nxori një copë bukë nga çanta, ja dha Muharremit dhe, mbasi e përqafoi atë, u largua.

Muharremi e ndoqi me sy komisarin dhe ashtu i përletur i tha: «Do të vij shoku komisar, do të vij patjetër do të vij, bashkë do të sulmojmë!»

Por komisari kishte kaluar një mur të gurtë dhe nuk i dëgjoi fjalët e partizanit.

Skënderi shpejtonte për në kodër. Sa kaloi disa driza, një zë u dëgjua nga maja e kodrës:

— Mos shpejto, o Skënder, se ka kohë!

Ai ishte komandanti i bataljonit II, N'kollaq Sallabanda.

Mbasi u përqaftua me të gjithë shokët, Skënderi u ndal pranë komandantit dhe po i tregonte atij çfarë kishin biseduar në mbledhje: për situatën, për sulmën e mbrëmjes dhe për detyra të tjera.

Komandanti nxori një kokërr patate të zier nga çanta dhe, pasi e ndau përgjysmë, njërën prej saj ja dha komisarit. Skënderi, pasi hodhi një vështrim mbrapa e rrotull për të parë mos kishte pranë ndonjë shok, e hëngri vetë. Të gjithë e dinin se ai kurë nuk hante gjë pa e ndarë me shokët.

— Erdhi komandanti, — tha dikush dhe sakaq të gjithë u çuan e të maskuar u afruan pranë vendit nga ku vrojtohej e gjithë fusha e luftimit.

Që nga fundi i Bioçës në lindje të Kosorrit, Cvarinit, Zlaticës dhe Dolanit dukeshin kodrat e fortifikuara të gjermanëve.

Komandanti u sqaroi mirë detyrën, ai u ndau sektorët e veprimit, u tregoi drejtimet e mësymjes, përqëndrimet e gjermanëve dhe, mbasi i pyeti në se ishin të qartë, u uroi sukses.

Mbasi mbaroi koordinimi i veprimeve luftarake, komandantët dhe komisarët e batalioneve, para se të ndaheshin, u përqafuan me njëri-tjetrin.

Të gjitha batalionet muarën drejtimet e tyre.

Batalioni I qëndroi aty afër dhe vazhdoi punën me komandantët dhe komisarët e kompanive për t'u sqaruar edhe atyre detyrën.

Kur komandanti mbaroi sqarimin e detyrës, Skënderi shkoi pranë disa partizanëve dhe po bisedonte me ta. Partizanët gjithmonë kishin dëshirë të bisedonin me të. Ai ishte i urtë, i thjeshtë dhe trim. Kur bisedonin me Skënderin, partizanëve u dukej vetja më e lehtë, ata dukeshin sikur kishin marrë energji të reja.

Komisari i batalionit I, Skënder Libohova, ishte luftëtar revolucionar, pjesëmarrës i demonstratave të para. Ai kishte dhe pasqyronte me të vërtetë tiparet e një komunisti të flaktë, ishte njeri i palodhur, i dashur me shokët, me partizanët dhe dinte t'i mobilizonte ata në luftë. Skënderi në situata të vështira e linte punën si udhëheqës dhe me shpejtësi mbushte automatikun, zbërthente gjerdanin e bombave dhe sulej përpara. Ishte plagosur tri herë. Kështu veproi edhe në betejën e Gëziqit në Mirditë. Kur kompania e tij e ndali mësymjen meqenëse gjermanët po bënë qëndresë të fortë, ai çau përpara, derisa u plagos kështu për të tretën herë dhe nuk mundi të vazhdonte më. Kudo ai ishte shembull dhe frymëzim për gjithë të tjerët.

— Shoku komisar, të dhemb më plaga? — e pyeti Rama Skënderin.

— Jo, — i tha komisari — nuk më dhemb, — Po Muharremi ishte pak i sëmurë.

— S'ka gjë shoku komisar, ai është shumë i fortë, ka pirë gjithmonë ujë malësie, mbasi dhe shtëpinë afër malit e ka.

— Jo, — tha komisari, — unë e pashë, ishte dobësuar pak dhe i këshillova shokët që të mos e marrin sot me vete, por ta strehonin diku pranë zjarrit.

— E ku rri pa ardhur ai, shoku komisar, asnjëherë nuk ndahet nga shokët!

— Shëndeti duhet ruajtur! — tha komisari.

— Ashtu është, — tha Rama, — duhet ruajtur! Por juve, shoku komisar nga plaga po ju rrjedh ende qelb!

— Shokë! — tha komisari. — Kjo është një luftë që kërkon sakrificë. Vetëm me vuajtje e mundime u çlirua Shqipëria. Partia jonë na ka mësuar të jemi kurdoherë dhe kudo të parët dhe ashtu si kemi luftuar të vazhdojmë të luftojmë edhe këtej kufirit. Ne do ta ndalojmë sulmin vetëm atëhere kur të mos ketë më këmbë fashisti dhe kur kudo të bëhet paqe.

Mbasi biseduan gjerë e gjatë, komisari i këshilloi të pushonin dhe ne mbrëmje të ishin gati. Në mbrëmje, në orën e caktuar e gjithë brigada u hodh në sulm. Partizanët nën errësirën e natës u afruan në distancat e hedhjes së granatave. Çdo batalion kishte zënë vendin e tij dhe sulmonte.

Në çdo anë buçisnin krisma të forta. Kodrat e Kosorrit, të Cvarinit e të Zlaticës si dhe krejt lugina e lumit Moraça ndriçonin nga armët e zjarrit,

nga shpërthimet e granatave dhe të predhave, nga lishkët shenjëdhënës që hidhnin gjermanët për të kontrolluar zonat e mbrojtjes.

Partizanët e batalionit I i muarën pozicionet e para, por hasën në një tjetër vijë mbrojtjeje ku gjermanët qëndronin me këmbëngulje. Kompania I çau përpara dhe doli në rrëzë të pyllit, në luginën e Zlaticës, ku duhej të ndërli dhej me batalionin II, por pa mbërritur mirë u kundërsulmua nga një forcë tjetër gjermane. Në këtë luftim të shkurtër u vra partizani trim Ram Arapi.

Kompanitë e tjera sulmuan nga krahu i majtë, por pa sukses.

— Do të shkoj unë! — tha komisarit, dhe pa marrë parasysh këshillën e komandantit, Skënderi u nis përpara.

Artilleria gjermane rrihte pa pushim formacionet e partizanëve.

Skënderi çau përpara përmes disa shkurreve i ndjekur nga dy partizanë, por pa zbritur ende në luginë edhe një i tretë u shtua dhe ju afrua komisarit.

— Erdha — i tha komisarit Muharremi, i cili kishte vuajtur shumë derisa natën vonë i kishte gjetur shokët.

— E ku vete, mor i uruar? — i tha komisarit.

— Nuk mund të rrija, shoku komisar, — i tha ai, — unë e ndjej veten më mirë tani.

Komisari, duke e ditur se ishte e kotë ta kundërshtonte Muharremin për të tilla gjëra, nuk e zgjati më, por me shpejtësi vazhdoi ecjen në drejtim të kompanive të tjera që ende luftonin në pllajën e afërt, në pamundësi që të ecnin përpara.

Kur partizanët panë se midis tyre erdhi komi-

sar Skënderi, u çuan dhe duke thirrur «Përpara partizanë!» sulmuan gjermanët me bomba dore. Gjermanët e humbën fare toruan. Pasi hodhi granatën e fundit, Skënderi u ul pranë një guri për t'u orientuar se ku ndodheshin kompanitë e tjera. E ku mund të orientoheshe atë natë!

Luftimet vazhduan deri në agimin e ditës tjetër. Kompania, me të cilën sulmonte Skënderi, mbërriti deri poshtë në luginën e dytë. Në këtë kohë, një numër i madh gjermanësh sulmoi në krah të tyre. Aty filloi një luftim i ashpër. Artileria gjermane qëllonte pa pushim mbi formacionet e partizanëve. Kodrat e Zlaticës u rënduan dhe më tepër nga pesha e coprave të predhave dhe të plumbave që u derdhën mbi to atë natë. Partizanët kërkonin me çdo kusht të mbanin majën e bardhë e cila kalonte herë në duart e gjermanëve dhe herë në duart tona. Gjermanët, pasi e rrahën me artileri këtë majë, e sulmuan përsëri nga të dy anët me bomba dore, por partizanët tanë, të udhëhequr nga komunisti Skënder Libohova u hodhën në kundërsulm. Filloi një përleshje e ashpër. Komisari qëllonte pa pushim mbi gjermanët dhe herë pas here kthente kokën nga shokët. Në të djathtë të tij u godit për vdekje partizani Dine. Komisari ju afrua, i zbërtheu xhakëtën dhe u mundua t'i ndalonte gjakun, por më kot. Ai kishte mbaruar. Me duar të përgjakura komisari u çua dhe u hodh me tërbim mbi gjermanët. Së bashku me të u çuan të gjithë partizanët. Në këtë luftim të afërt komisari u godit nga një predhë dhe ra me trup përpara, me kokë të mbështetur mbi automatik, mbi atë automatik që e donte aq shumë dhe me të cilin kishte shtrirë për tokë kushedi se sa fashistë. Ai ra duke thirrur:

«Të rrojë Partia Komuniste Shqiptare!» «Prejini rrugën gjermanëve!» Kur Muharremi pa se komisar i nuk monte më, tepër i dëshpëruar u çua në këmbë dhe me automatik në dorë u vërsul mbi gjermanët duke thirrur: «Hakmarrje, hakmarrje!» Mbasi vrau 3-4 vetë edhe ai ra në fushën e betejës.

Vdekja e Skënderit goditi rëndë zemrat e partizanëve të cilët e donin aq shumë këtë komisar të thjeshtë dhe guximtar, komisarin e demonstratave të para, komisarin e aksioneve të Myzeqesë, pjesëmarrësin e luftimeve në Operacionin e qershorit, e luftimeve për çlirimin e Beratit, të Kuçovës, të Mirditës, të Shkodrës dhe tani për çlirimin e Malit të Zi.

Mbi majën e bardhë midis Kosorrit dhe Zlatičës valoi flamuri i kuq shqiptar. Ndonëse të plagosur, Veip Çepani, Bilo Bregu, Zoi Bano, Pero Nepravishta dhe Zyra Xhaxho (dëshmore) i mbajtën fort këto kodra duke plotësuar kështu amanetin e Skënderit dhe të shokëve të tyre të rënë.

Në komunikatën e datës 18-19-20 dhjetor 1944 shtabi i brigadës njoftonte shtabin e Divizionit VI mbi këto luftime të ashpra, duke nënvizuar se u vranë 85 gjermanë dhe pati 60 të plagosur, ndërsa nga ana jonë u vranë 9 partizanë, midis të tjerëve komisar i batalionit të parë Skënder Libohova, të rinjtë komunistë Ferit Çela e Muharrem Osmanzeza.

NË NJË NATË BIEN TRE KOMISARË

Shumë komandantë, komisarë, partizanë dhe partizane muarën pjesë në varrimin e shokëve që ranë një ditë më parë në Mal të Zi.

Varret ishin hapur në afërsi të kishës së Medunit. Koha ishte e keqe, re të zeza sterrë ishin ulur deri në majat e kodrave të thepisura dhe bënte shumë ftohtë. Në afërsi të këtyre varreve ishin varrosur disa partizanë jugosllavë që ishin vrarë dy ditë më parë. Ne me sy të përlotur shikonim varret e shokëve tanë dhe të partizanëve jugosllavë që ndodheshin përbi njëri-tjetrit. Mbi varret e të rënëve tanë foli komandanti, i cili vuri në dukje heroizmat e tyre.

Një batare pushkësh ndërpreu mendimin e të gjithë të pranishmëve, të cilët u dhanë lamtumirën e fundit shokëve të rënë. Mbi varret e tyre në vend të kurorave, u vendosën shamitë e kuqe që partizanët i ruanin aq shumë. Partizanët u betuan se do të hakmerreshin për shokët e rënë.

Mbas ceremonisë së varrimit partizanët u shpërndanë në drejtimet e tyre. Ata provuan dhembjen



Dëshmori Haxhi Sade Leshnja

për shokët e rënë, por edhe një ndjenjë krenarie i kishte pushtuar: po përmbushnin një nga porositë e shokut Enver Hoxha, për të përfaqësuar denjësisht ushtrinë tonë përtej kufirit.

Përsëri e gjithë brigada do të hidhej në sulm dhe ja, sapo ra nata me sinjalin e caktuar dhe sipas drejtimeve, çdo batalion u hodh në sulm.

Batalioni II u fut thellë në luginën e Kosorrit. Në kompaninë që ishte komisar Haxhi Sade Leshnja bënin pjesë edhe partizanët Jashar Dinga, Isuf Muharremi dhe Qerim Komaraku. Ata së bashku me shumicën e kompanisë u këputën nga formacioni, çanë përpara në luginën e pyllëzuar dhe u afruan deri në buzë të xhadesë. Aty ecte pa pushim një divizion i tërë gjermanësh, pa llogaritur çetnikët, xhandarët dhe italianët që u qëndronin ende besnikë atyre.

Mbasi zunë vend afër lumit, partizanët hapën zjarr të befasishëm mbi gjermanët që tërhiqeshin dhe vranë mjaft prej tyre. Kjo skenë vazhdoi gjatë përderisa gjermanët e tjerë u dualën nga krahët dhe i sulmuan partizanët.

— Mbahu, Jashar! — i tha Haxhi'u. — Mos u tërhiq, shokët rrezikohen!

— Jo, — tha Jashari, — as unë, as Isufi nuk do të tërhiqemi që këndeje pa shkelur ata mbi trupin tonë.

Komisari pa se ishin futur thellë në formacionin e armikut, prandaj urdhëroi Qerimin dhe tre të tjerë të dilnin në krye të pyllit dhe të mos lejonin gjermanët të mbyllnin luginën, ndërsa vetë, së bashku me një skuadër, qëllonte mbi ta pa pushim.

Ky ishte një sulm i përgjithshëm. Brigada VI dhe VIII sulmonte nga krahu i djathtë, më në veri

sulmonte Brigada IX jugosllave; nga krahu i majtë, mbasi çliroi qytetin e Tuzit, Brigada XXII mësynte drejt qytetit Podgoricë. Kuptohet se në rast se brigada jonë do të dilte në vijën Bioç-Dolan, gjermanët në qytetin e Podgoricës do të mbeteshin të rrethuar.

Lufta u ndez e ashpër. Një grup partizanësh me komisarin në krye qëndruan të fundit, ashtu siç qëndroi i riu komunist Ferit Bregu në luftën e Paraspuarit në Operacionin e Qershorit. Feriti luftoi deri në fishekun e fundit; me mitralozin e tij korri gjithë ata gjermanë dhe së fundi me kokë të përgjakur luftoi edhe me gurë kundër këtyre barbarëve; po kështu veproi dhe grupi tjetër i udhëhequr nga zëvendëskomandanti i batalionit shoku Adil Prishta dhe komandanti i kompanisë III Teki Velehnja. Nga grupi i tyre u vranë të rinjtë komunistë Hekuran Nexhipi, Idriz Abdullaj, Mestan Avdyli, Sami Çuedari, Gori Kristo etj.

Në kohën që partizanëve po u buzëqeshte fitorja, Haxhiu me grupin e tij ndoqi gjermanët këmba-këmbës dhe përsëri me grupin e tij u përlesh me ta, por te ai vend i pyllëzuar, duke luftuar heroikisht, u godit nga një plumb armik, vuri dorën në bark dhe me automatik në dorë, ra me trup të përkulur përpara duke hedhur hapin e fundit dhe duke thirrur: «Për partinë, për Enverin përpara!»

Sulmin e vazhduan më tej partizanët e tjerë të komanduar nga komandanti i batalionit Nikollaq Sallabanda dhe komisar Bajram Radëshi. Batalioni II mbërriti deri në qendrën e banuar Bioç dhe e mori këtë nyje të rëndësishme në rrugën Podgoricë-Koloshinë.

Në këtë luftim të pabarabartë përveç komisarit

ranë heroikisht edhe partizanët Isuf Muharremi, Qerim Komaraku dhe u plagos rëndë Jashar Dinga, i cili, pasi vuajti shumë kohë, vdiq.

Batalioni III bënte presion të vazhdueshëm mbi kodrat lindore të katundit Dolan. Ai u shtri edhe më djathtas për të ndihmuar me zjarr batalionin II.

Mehdi Vila dhe Loni Jorgji ishin të dy shokë dhe të dy komisarë kompanie. Pasi biseduan për luftën e djeshme ata ndanë dhe detyrat e tyre për sulmin e asaj dite.

Kur u ndanë të dy shokët u përqaftuan duke i uruar suksese njëri-tjetrit dhe me grushtin përprjetë secili u nis në drejtim të tij.

Mehdi Vila ishte nga Vinokashi i Përmetit. Ishte një djalë i pashëm dhe mjaft i guximshëm. Në të gjitha luftimet ai ishte dalluar. Në Mirditë Mehdiu u plagos, por shpejt u shërua dhe i arriti shokët. Tani nuk ishte më komandant skuadre, por komisar kompanie dhe duhej të udhëhiqte shokët, duhej t'u fliste atyre se si të luftonin, si të ruheshin, si të vrisnin sa më shumë gjermanë, si të silleshin me popullin, t'u fliste atyre për të ardhmen. Metoda e tij më e pëlqyer ishte t'u tregonte atyre këto gjëra me shembullin vetiak duke qenë i pari në sulm dhe i fundit në tërheqje, i pari në vështirësi dhe njeri pa pretendime. Kështu kishte vepruar ai gjatë gjithë kohës së jetës partizane.

I tillë ishte dhe shoku i tij Loni Jorgji. Ai ishte nga Odriçani i Përmetit. Loni ishte edhe më i mbyllur se Mehdiu. Ai fliste pak, por gjithmonë i sigurtë në thënjet e tij.

«Do të sulmojmë! — i tha ai atë ditë Mehdiut. — Nuk di se si do të ndahemi sot me ta, por sa



Dëshmori Mehdi Vila.

vjen dhe këta katila, këta që rrënuan vendin tonë, po bëhen më të padurueshëm. Dje u vranë shumë shokë, midis tyre Gjergji, Zoi, Llambi, por sot — tha ai — do të sulmojmë dhe nuk do të ndalemi pa dalë në vijën Bicç-Podgoricë».

Sektorët ku do të vepronin të dy kompanitë nuk ishin shumë larg njëri-tjetrit. Ato do të sulmonin në krah kodrën më të lartë të Zlaticës dhe do të bashkoheshin poshtë, buzë lumit Moraça, duke lënë të rrethuar gjermanët që mbaheshin të fortifikuar në kodrën gjysmë të pyllëzuar.

Në të dy krahët e kodrës, dy kompanitë u ndanë në drejtime të ndryshme, por me një pikë takimi — atje poshtë te ura. Sulmi vazhdoi deri vonë dhe gjermanët që mbroheshin në këtë majë malë ishin gati duke u rrethuar, bile edhe 200 m. dhe në agim të gjithë do të ishin të rrethuar.

Dy fishkëllima të forta u dëgjuan nga ana e kompanisë së Mehdiut dhe Loni ju përgjegj këtij sinjali. Por papritur gjermanët i lëshuan pozicionet e tyre në atë pllajë dhe ja mbathën drejt urës.

Të dy kompanitë luftuan heroikisht duke mos i lejuar gjermanët të kalonin. Luftimet arritën deri trup me trup me gjermanët që kërkonin me çdo kusht të tërhiqeshin drejt urës. Nga ana tjetër të dy kompanitë kërkonin që po me çdo kusht të asgjësonin forcat gjermane, ose t'i zinin ato rob.

— Bjeru, o Loni! — thirri Mehdiu — me sa kishte në kokë. Loni, si zakonisht, nuk fliste shumë, ai ishte mbështetur në një ledn dhe qëllonte pa pushim mbi gjermanët.

Gjermanët duke përfituar edhe nga terreni, mbasi ishin nga ana e sipërme, shpërthyen në drejtim të kompanisë së Lonit dhe çanë rrethimin.



Dëshmori Loni Jorgji

Aty, duke luftuar ashtu si u ka hije partizanëve, mbeti i vrarë komisar Loni së bashku me partizanin Banush Manko.

Kur Mehdiu pa me sytë e tij këtë skenë, ai me disa partizanë të tjerë u hodh mbi ta, duke shtrirë për tokë me dhjetëra fashistë.

Nga të katër anët buçitën zërat «Përpara partizanë!» dhe lugina e lumit Moraça oshëtiu për herë të fundit nga krismat e armëve të partizanëve shqiptarë. Në të gjithë vijën e sulmit u shënuan suksese të rëndësishme. Batalioni III së bashku me disa batalione të tjera zbriti deri poshtë dhe kapi me lehtësi pozicionet e armikut, ndërsa Batalioni II u fut në Bioç.

Kompania ku ishte Mehdiu u përlesh keq me gjermanët, deri sa i detyroi të tërhiqeshin. Nga xhadeja përtej, të tjerë gjermanë zunë të qëllonin mbi kompaninë e pambrojtur. Mehdiu me disa shokë u preu rrugën disa gjermanëve dhe u tha: «Ndaluni fashistë, jepni llogari për shokët tanë!» Por gjermanët nuk u dorëzuan, ata u përgjegjën me zjarr.

Mehdiu dhe shokët e tij qëlluan. Tre-katër fashistë u shtrinë për tokë, ndërsa tre të tjerë ngri-tën duart lart dhe u dorëzuan. Mehdiu i çarmatosi me shpejtësi, ja dha një partizani t'i çonte në prapavijë dhe me Dinon e me disa partizanë të tjerë, duke vazhduar me shpejtësi nëpër disa shkurre, doli në një kodër të vogël dhe filloi të qëllonte pa pushim mbi gjermanët.

Gjermanët e panë se partizanët nuk po u ndaheshin dhe ndërmorën përsëri një kundërsulm nga të dyja anët, duke i vënë partizanët në pozita të vështira. Partizanët luftuan me heroizëm të rrallë

dhe i zbrapsën disa herë kundërsulmet e gjermanëve, por në fushën e betejës ra i katërti komisar përtej kufirit. Por partizanët të cilët ende dëgjonin fjalët e komisarit: «Përpara shokë», «Zirini të gjallë!», u hodhën në sulm, dualën në pllajën përballë ku vrojtuan se gjermanët po tërhiqeshin me shpejtësi, ndërsa poshtë në luginë panë shumë ushtarakë me uniforma të gjelbëra, të strukur nëpër shkurre.

— Dorëzohuni, fashistë! — u thirri komandanti.

— «Noi siamo italiani»¹⁾ — u përgjegjën ata njëzëri dhe sakaq 64 italianë ngritën duart lart.

Të gjithë italianët u çarmatosën dhe u dërguan në shtab. Fusha e përgjakur rënkonte rëndë, por sukse si ishte i dukshëm. Bioça dhe i gjithë rrethi i Podgoricës u çlirua. Vetëm kompania e Mehdiut përveç robërve që zuri të gjallë vrau dhe 40 gjermanë.

Në të gjithë luginën e lumit Moraça u zu mjaft material luftarak, si 7 topa, dy autoblanda dhe mjaft municion.

Atë javë u shënuan sukse të rëndësishme për gjithë brigadën. Por nga forcat tona mbetën në fushën e betejës mjaft shokë. Brenda një nate dhanë jetën e tyre për çlirimin e Malit të Zi tre komisarë, të cilët me gjakun e tyre e ngritën më lart emrin e komisarit, emrin e partizanit dhe luginë e Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare. Megjithatë humbjet tona në krahësim me të armikut qenë shumë më të pakta.

1) «Ne jemi italianë» (it.)

PUSHIMI I SHKURTËR

Mali i Zi u çlirua. Partizanët e brigadës sonë po pushonin në katundet përreth qytetit të Podgoricës.

Një skuadër partizane me në krye Rustem Harizin pushonte në një shtëpi të vjetër në katundin Dolan. Shtëpia ishte e ulët, e filluar me gurë dhe pastaj e mbaruar me drurë të çarë të vënë në këmbë. Përpara kishte një oborr të vogël, të rrethuar me mur guri. Shtëpia gjithsejt kishte një dhomë, një hajat të pabanueshëm dhe një kuzhinë të vogël.

Në njërën anë të dhomës u vendos një skuadër partizane, ndërsa në anën tjetër ishte shtrirë e sëmurë rëndë e ëma e të zotit të shtëpisë. Familja e tyre përbëhej nga shtatë vetë: i zoti i shtëpisë, e shoqja, katër fëmijët dhe gjyshja. Ishin shumë të varfër.

Aty partizanët pushuan disa ditë me radhë. Ata u njojtën mirë me të zotin e shtëpisë, biseduan për luftën e partizanëve shqiptarë përtej kufirit, për sakrificat e tyre dhe për të ardhmen. Në fillim i zoti i shtëpisë sikur mbante një qëndrim indiferent,

por më vonë ai u bind për gjithshka. Ata për pesë ditë rresht shikonin se çfarë hanin partizanët shqiptarë: hanin patate të ziera, herë ndonjë copë bukë që e gjenin me vështirësi intendentët dhe ndonjëherë asgjë fare. Por edhe partizanët shikonin se çfarë hante i zoti i shtëpisë me fëmijët e tij: ata hanin vetëm patate, ndërsa gjyshes i bënë supë me kripë.

Kur panë të zotët e shtëpisë se partizanët shqiptarë nuk kërkonin asgjë, kur panë se ata sillëshin aq mirë filluan të mbanin një qëndrim më të afërt me ta. Një ditë i zoti i shtëpisë shkoi tre-katër orë larg dhe solli dru për t'u ngrohur partizanët.

Në mbrëmje pranë zjarrit përsëri filloi bashkëbisedimi midis të zotëve të shtëpisë dhe partizanëve.

— A keni ngrënë gjë sot? — ju drejtua i zoti i shtëpisë Rustemit, përgjegjësit të partizanëve.

— Kemi ngrënë! — ju përgjegj Rustemi.

— Jo, — tha e zonja e shtëpisë, — ata s'kanë ngrënë asgjë.

— Jepu ca patate! — ju drejtua ai së shoqes.

— Nuk duam, — tha Rustemi. — Ju faleminderit shumë për strehimin dhe zjarrin që na bëni!

E zonja e shtëpisë kaloi në anën tjetër dhe solli disa kokrra patate.

— Ne, — tha i zoti i shtëpisë, — kemi vuajtur shumë. Plakun tim e vranë italianët. Gjermanët më vranë vëllanë që banonte këtu afër. Në Podgoricë u vra tezja me të nipin nga bombardimet e anglezëve. Çetnikët më muarën gjithshka që kisha dhe mua tani më ka mbytur skamja. Plaka, gruaja dhe fëmijët ju i shikoni vetë se sa shumë janë dobësuar.

— Së shpejti, — tha Rustemi, — këtu do të

ngrihet pushteti lokal, që do të interesohet për ju, do t'ju sjellë ushqime, veshje dhe gjithshka tjetër, prandaj mos u mërzitni, fitorja do të jetë me ju.

— Thonë, — tha i zoti i shtëpisë, — se këtu do të vijnë anglezët. A është e vërtetë, pyeti ai, — se ata janë shumë të pasur dhe ndihmojnë popujt e shtypur?

— Po cili i pasur, o xhaxho, ndihmon fukarane? Cili i pasur të ka dhënë ty ndonjë gjë falas? — ju drejtua Rustemi të zotit të shtëpisë.

— Mua, — tha i zoti i shtëpisë, — asnjë i pasur s'më ka falur gjë!

— Në qoftë se anglezët hyjnë këtu ata do të hyjnë vetëm me qëllim të keq, vetëm për të nënshtruar vendin tuaj. Ne në Shqipëri nuk i lemë ata të futin hundët se e njohim politikën e tyre, — tha Rustemi. Pse ata e rrënuan Podgoricën në atë mënyrë që ajo nuk njihet si qytet dhe ne po strehohemi në këto shtëpi të vjetra? A mos vallë në lagjet e qytetit kishte gjermanë?

— Jo, — tha plaku, — nuk kishte.

— Pse nuk bombardonin forcat gjermane në kodrën e Podgoricës, në kodrat e Cvarinit, të Zlaticës, të Bioçës e të Tuzit ose bateritë e artilerisë gjermane? Ata, o xhaxho, edhe ne na mitraluan, ata çdo gjë e bëjnë me qëllim që të nënshtrojnë popujt e tjerë.

— Po, — tha plaku, — që prej kohësh kemi dëgjuar se Anglia është dhelpër. Ne, në të vërtetë, kur dëgjonim luftën në majat e larta, bombardimet në qytet dhe në luginë mendonim se në Podgoricë do të hynte ushtria angleze, dikush thoshte se do të vinte Ushtria e Kuqe, dikush thoshte se do të vinin vetë partizanët jugosllavë. Në të vërtetë në

Tuz, në Podgoricë, në Bioç e kudo këtu te ne, mbas gjithë asaj lufte të ashpër hynë partizanët shqiptarë.

— Po, o xhaxho, partizanët shqiptarë hynë, por ne kemi ardhur me qëllime të ndryshme nga ushtritë e tjera. Shtatë brigada shqiptare me urdhërin e partisë, me urdhërin e Enver Hoxhës, kaluan kufirin dhe kanë një muaj që po luftojnë për të ndihmuar popullin vëlla jugosllav. Ne do ta ndjekim armikun deri në shfarosjen e tij të plotë dhe pastaj përsëri do të kthehemi në atdheun tonë. Ushtria jonë është ushtri e dalë nga gjiri i popullit, edhe ne jemi djegur, edhe ne jemi shkatërruar dhe jemi vrarë nga lufta, por ju duhet ta dini se pa gjak e pa sakrifica nuk fitohet liria.

— A u vranë shumë shqiptarë këtu në Mal të Zi?, — pyeti i zoti i shtëpisë.

— Shumë janë vrarë, o xhaxho, shumë, vetëm nga brigada jonë janë vrarë dhjetëra partizanë veç të plagosurve. Në Mal të Zi u bë një luftë e ashpër, e parë rrallë në histori. Këtë luftë e pa me sytë e tij populli i Malit të Zi, e panë partizanët jugosllavë, e panë ushtarakët sovjetikë.

— Sovjetikët?! — pyeti plaku me habi.

— Po, o xhaxho, përfaqësuesit e Ushtrisë së Kuqe ishin aty lart në majat e thepisura dhe ata e panë me sytë e tyre luftën e Divizioneve tona, madje nesër do të flasin përpara nesh këtu në sheshin e madh.

— Sa për luftën e partizanëve shqiptarë e kemi të qartë, — tha plaku. — Ne atë e pamë me sytë tanë, ju nuk kursyet asgjë, ju ishit nga të parët që na sollët lirinë dhe hytë në rajonet tona si çlirimtarë. Por nesër kam qejf të vij dhe unë aty t'i shikoj ata sovjetikët.

— Të vish, o xhaxho, të vish, — i tha Rustemi. Bashkëbisedimi vazhdoi deri vonë. Të zotët e shtëpisë dëgjonin me vëmendje fjalët e Rustemit. Vetëm gjyshja rënkonte herë pas here në shtratin prej dërrase të ngritur një pëllëmbë nga niveli i tokës.

Dy brigada ishin rreshtuar në sheshin e madh. Ja aty në krahun e djathtë ishte rreshtuar Brigada VII Sulmuese, pastaj Brigada XXII Sulmuese. Dita ishte e bukur dhe ne të rreshtuar pritnim të vinte komanda e divizionit së bashku me përfaqësuesit e Ushtrisë Sovjetike.

Ishim kureshtarë të shikonim përfaqësuesit e Ushtrisë së Kuqe. Për ta kishim dëgjuar mjaft, komisarët na kishin folur për sukseset e ushtrisë sovjetike, na kishin folur për betejën para Moskës, për betejën e Stalingradit, për betejën e Kurskut, ndërsa tani, ajo marshonte drejt Berlinit.

— Erdhën! — tha dikush, dhe të gjithë kthyen kokën në drejtim të grumbullit të ushtarakëve që po afroheshin në drejtimin tonë.

— Gatitu! — u dha komanda.

Të gjithë nderuan në drejtim të shokëve të shtabit që po afroheshin.

Një oficer sovjetik me gradën nënkolonel, i shoqëruar nga komandanti i brigadës, kaloi në revistë të gjithë rreshtimin partizan duke nderuar që nga fillimi e deri në fund.

Aty pranë kishin ardhur dhe shumë fshatarë për të parë përfaqësuesit sovjetikë dhe ushtrinë shqiptare.

Mbasi folën shokët e shtabit të divizionit, e mori fjalën përfaqësuesi i Ushtrisë së Kuqe. Ai solli përshëndetjet e Ushtrisë së Kuqe dhe foli me zjarr

dhe admirim të madh për luftën e popullit shqiptar.
Të gjithë partizanët dëgjonin me vëmendje të madhe.

— Sikur i ngjan shumë atij sovjetikut që erdhi në Helmës — tha Vala, një delegate në Kongresin I të rinisë.

— Po mund të jetë ai, — tha Faiku.

Nënkoloneli i Ushtrisë së Kuqe midis të tjerave tha:

«Ne kemi dëgjuar në radio dhe kemi lexuar në shtyp, për luftën që ka bërë populli shqiptar, por ne patëm mundësinë ta shihnim me sytë tona luftën që zhvilluat ju në kodrat e Kosorrit, të Zlaticës dhe të Bioçës. Miqësia jonë po forcohet edhe më shumë»¹⁾.

Mijëra vetë brohoritën me gjithë shpirt për Bashkimin Sovjetik, për Ushtrinë e Kuqe dhe për Stalinin e madh.

Ai takim mbeti i paharruar në kujtesën e partizanëve.

Mbas meetingut filluan këngët dhe vallet. Në mbrëmje përsëri Rustemi së bashku me skuadrën vajtën në bazën e caktuar. I zoti i shtëpisë, i cili edhe ai mori pjesë në meeting ishte i gëzuar nga fjalimet që kishte dëgjuar.

Një ditë erdhi nga Shkodra bukë e bardhë dhe të gjithë partizanëve, intendentit u ndau nga një bukë të plotë.

Partizanët prenë nga një copë nga racioni i

1) Arkivi Qendror i Ushtrisë. Fondi Brigada VII. Dosja Nr. 4.

tyre dhe ja dhanë të zotit të shtëpisë, ndërsa të sëmurës i dhanë pak më tepër.

— Oh, — tha i zoti i shtëpisë, — bukë e bardhë! — Nga Shqipëria ka ardhur?

— Po, — tha Rustemi, — nga Shqipëria.

Plaku filloi të hante.

— Sa e mirë që është! — tha ai. — Sa vjet kam pa ngrënë bukë të bardhë!

Dhe menjëherë u ndau fëmijëve të tij nga një copë bukë të bardhë.

Partizanët përsëri mbetën pa bukë dhe në të njëjtën kohë po përgatiteshin të marshonin drejt Bosnjës.

— Ku do të shkoni? — pyeti i zoti i shtëpisë.

— Të ndjekim armikun — i tha Rustemi.

— Po deri ku? — vazhdoi ai.

— Deri në Berlin, — i tha Rustemi. — Derisa të mos mbetet këmbë fashisti!

— Sa marshim i gjatë! — tha plaku. Po ju s'keni ngrënë bukë!

— S'ka gjë, — tha Rustemi, — ne edhe pa bukë do të marshojmë, kjo nuk është hera e parë. Bukën, municionin dhe veshmbathjen përsëri do t'ja marrim armikut.

Para se të përshëndeteshin me ta, të zotët e shtëpisë e ngritën të sëmurën nga shtrati. Te ai vend, poshtë shtratit, kishin fshehur gjysmë thesi me bollgur. Kjo ishte rezerva e tyre e fundit. Tnesin e bollgurit e kishin shtrirë dhe e kishin shpërndarë në mënyrë të barabartë që të dukej tamam si dyshek. Nga bollguri ata i dhuruan skuadrës

partizane një çantë plot për ta patur si rezervë gjatë atij marshimi të gjatë.

Rustemi e mori bollgurin, i falënderoi të zotët e shtëpisë dhe u ndau partizanëve nga një gavetë.

I zoti i shtëpisë, gruaja dhe fëmijët e tij dolën deri përjashta, i përcollën partizanët shqiptarë dhe ju uruan sukses, i uruan të ktheheshin shëndoshë e mirë në Shqipëri.

MARSHIM I VËSHIRË

Bora dhe të ftohtit e madh nuk e ndalën marshimin e partizanëve. Ata, si gjithmonë, ecnin përpara me këngët e luftës partizane, për të kryer deri në fund misionin e tyre historik.

Rruga vazhdonte gjatë bregut të djathtë të lumit Moraça. E gjithë lugina nxinte nga retë e dendura.

— Sa është ora, o Ferit? — pyeti Rustemi.

— Një, — ju përgjegj ai.

— Para një ore në Shqipëri janë shuar dritat dhe kanë lajmëruar ardhjen e vitit të ri.

— Po, — u përgjegj Rustemi, — i pari Vit i ri që festohet në Shqipërinë e re socialiste.

Pikërisht në këtë orë, kur në Shqipërinë e lirë festohej i pari Vit i ri, divizioni ynë vazhdonte të përleshej me armikun, e ndiqte atë këmba-këmbës dhe marshonte përpara. Rruga ishte shumë e vështirë, përveç dimrit të madh dhe terrenit të vështirë malor, kishte dhe vështirësi të tjera. Nga bora dhe shirat e shumtë ishin zënë rrugët, shumë ura ishin

shembur nga shirat, nga gjermanët ose nga ndonjë bombardim aleat.

Gjatë rrugës binin në sy mbeturinat e një be-teje të vërtetë: në këto gryka e gërxe kishin luf-tuar partizanët shqiptarë dhe mbas një jave këto mbeturina ende nuk ishin zhdukur. Kudo shihje gjermanë të vrarë, kuaj të ngordhur, karro, ma-qina, autoblanda dhe topa të shkatërruar, më tej dukej një autoambulancë e shkatërruar me kufoma të djegura.

Partizanët atë natë pushuan në majat e Jabla-nit. Bënte shumë ftohtë dhe qielli kishte filluar të kthjellohet. Partizanët, të lodhur nga marshimi i gjatë e të pangrënë, filluan të ngroheshin pranë zja-rreve që sapo kishin ndezur.

Një zhurmë që sapo vinte e afrohej u dëgjua nga perëndimi.

— Shuani zjarret! — u dëgjua zëri i koman-dantit.

Partizanët brenda disa sekondave shuan zjarret dhe sakaq i drejtuan sytë në drejtim të perëndimit, ku dalluan tre aeroplanë që fluturonin në drejtim të verilindjes. Rastet e hidhura i detyronin parti-zanët të mbroheshin edhe nga anglezët edhe nga gjermanët, megjithëse aviacioni gjerman në atë ko-hë ishte shumë pasiv. — Por aeroplanët u kthyen dhe u zhdukën në drejtim të perëndimit.

Partizanët përsëri i ndezën zjarret. Atë natë aeroplanët nuk u dukën më. Partizanët muarën nga një sy gjumë duke patur për dyshek borën e butë, për jastëk nga një copë gur dhe për mbulojë ve-tëm kapotat dhe palltot e vjetra që kishte secili.

Të nesërmen që pa gdhirë filloi marshimi. Ko-

ha ishte e kthjellët, por bënte shumë ftohtë dhe frynte erë e madhe.

Batalionet kaluan njëri pas tjetrit kthesat e ashpra të Lieva-Rekës.

Partizanët kishin 24 orë që marshonin pa ngrënë. Dikush kishte gjetur ndonjë kokërr patate në rrugë dhe e përtypte atë të gjallë. Faiku me disa shokë hanin rezervën e bollgurit pa e zier. Marshimi sa vinte dhe bëhej më i vështirë. Morali i partizanëve ishte i lartë, asnjëri nuk kërkonte bukë, asnjëri nuk thoshte se ishte lodhur, se nuk e merrte dot mitralozin, asnjëri s'e shkëpuste rreshtin, por të gjithë marshonin përpara.

Mbasdite partizanët mbushën 30 orë pa ngrënë. Lodhja ishte e madhe dhe e papërshkruar. U vendos të pushonin në afërsi të Matashevos, në një grykë, te disa godina prej druri të braktisura dhe pjesërisht të pabanueshme.

Një shok jugosllav nga të komandës së vendit njoftoi se s'kishte asnjë shtëpi për të na strehuar, s'kishte asnjë copë bukë për të na furnizuar, mbasi banorët përqark ishin të dëmtuar dhe nuk kishin asgjë, madje as patate.

Disa fshatarë shikonin me kureshtje partizanët shqiptarë. Sigurisht para pak ditësh ata kishin parë dhe kishin dëgjuar për luftën e ashpër që zhvilluan partizanët shqiptarë në këto gryka e gërxhe.

Por tani këta partizanë ishin të lodhur, të shtrirë andej-këtej dhe dukeshin sikur i kishin humbur fuqitë e tyre. Por jo! Te sytë e partizanëve dallohej forca, dallohej vendosmëria e tyre për të vazhduar përpara.

Partizanët ndezën zjarret dhe u bënë gati të

pushonin. Ndërkohë një fshatar jugosllav solli një dem për ta ngrënë partizanët.

— Merreni! — tha ai. — E paçi hallall! Ky dem më ka mbetur, e kisha fshehur larg në pyll, por po jua fal, se e meritoni. Ju po luftoni për të mirën tonë, për të zhdukur fashizmin, atë që na shkatërroi shtëpitë, që na dogji dhe na vrau.

Partizanët e kundërshtuan, por ishte e kotë. Sakaq fshatari nga kasollet e Matashevos nxori thikën dhe e theri vetë demin, pastaj ftoi partizanët ta piqnin në zjarr dhe ta hanin.

— Nuk e mbaj mend, — tha Seiti, — ta kem parë veten time më keq se sa sot.

Skuadra e Seiti pushoi në një haur prej dërrase dhe të gjithë i zuri gjumi.

Por Seiti nuk flinte. Ai shikonte rreth e qark dhe nuk i durohej pa ngrënë diçka.

Në tavanin e aurit ai pa një dritare të vogël. U mundua të hipte, por ishte e pamundur. Me ndihmën e një druri të gjatë të cilin e mbështeti pas murit, ai hipi deri sipër me shpresë se do të gjente ndonjë gjë për të ngrënë. Por më kot, se nuk gjeti gjë. Kishte vetëm koçanë misri. Edhe një herë kontrolloi në errësirë, por përsëri s'gjeti asgjë. Mori një koçan dhe tek e rrotullonte nëpër duar dallooi në fund të tij një kokërr misër. Filloi të kontrollonte të gjithë koçanët që ndodheshin në tavan. Disa kishin nga një kokërr, disa nga dy, kishte dhe nga ata që kishin 3-4 kokrra të vogla ose asnjë.

Mbas nja dy orësh punë Seiti mundi të sigurronte 400-500 gram kokrra misri. Zbriti poshtë, mori një kuti konservash nga të gjermanëve, e lau dhe mbasi e mbushi me ujë filloi ta ziente misrin në të.

Ndaj të gdhirë, pasi e zjeu misrin, ai i zgjoi shokët për të ngrënë.

Edhe intendentët tanë bënin shumë përpjekje për të na siguruar ushqim. Të hollat nuk u mungonin, po ku ta gjenin ata të shkretët ushqimin, ku ta blenin, sepse atë vit asgjëkund nuk shitej bereqet.

Në mëngjez kur po bëheshin gati për t'u nisur në vend që të vinte itendenti për të sjellë diçka për të ngrënë erdhi lajmi se ai, bashkë me tre shokë të tjerë, ishte plagosur¹).

Si kishte ndodhur?

Itendenti, një luftëtar i vjetër bënte çmos që partizanët të mos mbeteshin pa ngrënë.

Në buzën e lumit Moraça në kthesat e Jablanit e të Lievo-Rekës kishte shumë gjermanë të vrarë. Këtu ai kontrolloi të gjitha pozicionet e braktisura të armikut që ishin nën tokë dhe në sipërfaqe. Në disa vende ai kishte gjetur fishekë, batanije, patate e të tjera. Një ditë më parë ai urdhëroi partizanët që të zhvishnin rrobat e disa gjermanëve të vrarë. Nga xhepi i kapotës së një gjermani të vrarë, plasi një bombë dhe u plagos vetë itendenti bashkë me tre partizanë. Fashistët gjermanë për të dëmtuar forcat tona ose qytetarët tanë nuk mungonin të shfrytëzonin edhe kufomat e shokëve të tyre, për të vazhduar krimet e tyre barbare.

Mbas një marshimi tepër të vështirë partizanët arritën në afërsitë e Andrievicës, ku vetë fshatarët u siguruan diku patate, diku bukë thekre dhe diku kaçamak. Natën e tretë partizanët hëngrën diçka.

Duke vazhduar marshimin partizanët ju afruan

1) Arkivi Qendror i Ushtrisë. Fondi Brigada VII. Dosja Nr. 3.

qytetit Berane. Bora vazhdonte të binte pa pushim. Por atë ditë megjithëse bora vazhdonte të binte, të ftohtit ishte zbutur dhe partizanët përgatiteshin për të parakaluar para popullit të këtij qyteti, para këshillit nacionalçlirimtar, para komandës sonë dhe asaj jugosllave.

Populli i qytetit dhe i fshatrave përreth i priti në mënyrë miqësore dhe të ngrohtë partizanët Shqiptarë.

Simpatia që kishin vendasit për partizanët shqiptarë, ishte e madhe. Kur partizanët ndaluan më tej se qendra e qytetit, mijëra vetë u grumbulluan rreth tyre, i shikonin me dashamirësi dhe thërrisnin: «Të rrojë ushtria shqiptare!» «Të rrojë Partia Komuniste Shqiptare!», «Të rrojë shoku Enver Hoxha!» e tjera.

Shumë vendas kishin në duart e tyre shishe me raki dhe u jepnin partizanëve nga një gotë, dikush u ndante nga një kokërr mollë dhe dikush i përgëzonte dhe u uronte sukses.

Partizanët kënduan dhe hodhën valle disa orë së bashku me ta. Në gjithë qytetin kishte gjallëri të madhe.

Mbas pak partizanët u larguan. Populli i përco-lli deri në të dalë të qytetit. Lamtumira e fundit u dha sipas zakonit të vjetër shqiptar me të shtëna pushkësh.

Batalionet marshuan drejt Bielopoles dhe mbasi e lanë këtë qytet u kthyen majtas dhe vazhduan, përmes pyjeve Sahaviç në xhade, në perëndim të malit Rançarevo.

Në vazhdim të këtij marshimi të vështirë filloi të bjerë shi i përzjerë me borë.

Po afrohej muzgu i mbrëmjes dhe ata ende nuk e kishin kaluar një pjesë të lumit Ravna.

Rruga sa vinte bëhej edhe më e vështirë.

«Shpejtoni hapin» — u dha komanda dhe të gjithë menjëherë filluan të ecnin më shpejt. Me t'u afruar lumit në atë të ftohtë të madh pothuajse të gjithë deshën të kalonin lumin zhveshur. Mirëpo ndalesa më e vogël ishte në dëmin e tyre. Mali Gradinë duhej patjetër të kalohej pa u errur, përndryshe në atë borë, në atë të ftohtë e në rrugë pa rrugë kalimi i tij bëhej më i vështirë.

Komisari i brigadës, shoku Qazim Kapisyzi, doli përpara dhe i pari kaloi lumin i veshur, pas tij u hodhën komandanti, shoku Musa Daci dhe mbas tyre të gjithë të tjerët. Në këtë mënyrë për disa minuta lumi u kalua dhe partizanët në errësirë dhe me vështirësi të madhe kaluan malin e Gradinës dhe nga mesi i natës mbërritën në katundin Kozica, nga ku qyteti i Plevles nuk ishte shumë larg.

PLAKU DHE PICIRRUKU

Partizanët ju afruan qytetit të lashtë Plevle. Mbas stuhisë që ndodhi një ditë më parë dukej sikur natyra kishte rënë në qetësi. I gjithë vendi zbardhte nga bora që kishte rënë.

Megjithëse ky vend ishte malor, me një lartësi mesatare 1400-1500 metra mbi nivelin e detit, kodrat e vogla në periferi, i jepnin kësaj zone një bukuri të rrallë, e tregonin atë si vend fushor.

Sa më afër i afrohesh qytetit, aq më tepër dallohen shtëpitë dhe xhamitë karakteristike të këtij qyteti të vjetër.

Dy kolona nga drejtime të ndryshme marshonin përpara dhe sa vinte kreu i tyre po afrohej më tepër derisa u takuan në një shesh afër lagjes së jashtme.

Pas atij marshimi të gjatë dhe të vështirë, në qytet u bë një pushim i shkurtër. Filloi një aktivitet i madh, si në drejtim të punës së partisë ashtu dhe në drejtim të organizimit. U muarën disa masa higjieno-sanitare dhe u zhvillua një aktivitet kultural.

Nga gjithë ai marshim i gjatë dhe i vështirë dy

shokë u sëmurën rëndë. Atyre ju dha ndihma e ras-tit, por gjendja e tyre sa vinte dhe keqësohej.

«Sa keq, — thoshte Qemali, — që nuk mund të ngrihem dhe të vazhdoj me ju!»

Ai ishte shtrirë pranë zjarrit dhe ngrohej i mbuluar me një batanie italiane, ndërsa shoku i tij, edhe ai i sëmurë, nuk përmendej fare, por qëndronte shtrirë dhe palëvizur.

Në një dhomë tjetër rrinte plaku partizan Rako Sinja, i cili kishte marrë pjesë në disa luftime. Ai ishte i dobët, me trup pak të përkulur, por i fortë dhe i aftë për të përballuar çdo vështirësi.

Plaku Rako ose xha Rakua, siç e thërrisnin partizanët, e përdorte mirë mitralozin e rëndë italian «Fiat». Me të filluar lufta xha Rakua zgjidhte pozicionin sido që të ishte ky, qoftë i fortifikuar qoftë i hapët, mjaftonte të vrojtohej që atje fusha e luftimit dhe ulej në tokë, vendoste mitralozin midis këmbëve dhe qëllonte mbi fashistët.

Kështu luftoi xha Rakua që nga mali i Shpiragut dhe deri në Mirditë, që nga Shkodra e deri në Mal të Zi dhe ishte i vendosur që së bashku me partizanin e vogël, të cilin e thërriste «Picirruk», të shkonte deri në Berlin.

Kush e kishte në mbështetje me mitraloz xha Rakon i kishte krahët të sigurt. Shumë herë e lavdëronin xha Rakon për gjakftohtësinë dhe sigurinë e tij, madje thoshin se po të jesh me të, nuk të gjen gjë kurrë.

Tani xha Rakua në moshë shumë të kaluar ishte lodhur dhe kishte filluar të dobësohej. Komanda e brigadës nxori një urdhër për të kthyer në Shqipëri partizanët nën moshën 15 vjeç, pleqtë dhe robërit.

Por xha Rakua dhe Picirruku nuk pranuan.

«Jo, — thoshin ata, — ne nuk kthehemi, ne nuk ndahemi, do të vemi deri në Berlin, lufta nuk ka mbaruar, detyrën tonë do ta çojmë deri në fund!»

— Jo, — shoku komisar, — tha Picirruku — unë nuk jam 15 vjeç, pse në vend rri unë? Unë 15 vjeç isha që në luftën e Tendës së Qypit, ndërsa që atëhere kanë kaluar dy vjet! Unë nuk ndahem nga shokët e mi, kemi thënë se armikun do ta ndjekim deri në Berlin, apo jo shoku komisar?

— Po, — tha komisar, — do ta ndjekim armikun, por mjaft jemi ne. Tani ushtritë e popujve përparimtarë sa vinë e po shtohen, kuçedra fashiste i ka ditët e numëruara, prandaj ti kthehu në Shqipëri, atje do të futesh në shkollë, do të dalësh oficer dhe do të bësh pjesë në ushtrinë e rregullt shqiptare.

— Oh, — tha «Picirruku», — kur të mbarojë lufta patjetër do të shkoj në shkollë, por tani s'ka se ç'më duhet shkolla, tani për mua shkollë është pushka, automatiku, mitralozi, ata unë i përdor mirë. Pastaj, — shoku komisar, — kam dëshirë të luftoj dhe t'i ndjek ata të poshtër deri në Berlin. A të kujtohet në fshatrat Krushovë, Kapinovë dhe Vlushë sa të pafajshëm pushkatuan ata të poshtër? Është e vërtetë që ne kemi vrarë shumë prej tyre, por hakmarrja duhet të vazhdojë ajo duhet të mbarojë vetëm atëhere kur këmbë fashisti të mos mbetet. Prandaj, shoku komisar, ju lutem të më lejoni të vij edhe unë me ju.

Çështja e partizanit të vogël, vajti deri te komisar i brigadës, dhe së fundi u vendos që «Picirruku» të qëndronte për të vazhduar luftën edhe më tej. U gëzua shumë që u bë ky përjashtim për të,

dhe qysh atë ditë ai filloi të punonte edhe më mirë, të ishte më i qeshur dhe më i papërmbajtur në luftë.

Por edhe xha Rakua nuk donte të kthehej në Shqipëri. Vrulli revolucionar që nga të rinjtë dhe deri te pleqtë në atë kohë ishte i papërmbajtur. Asnjëri nuk donte të kthehej mbrapa, të gjithë ishin rrugëtarë të një qëllimi, për zhdukjen e fashizmit.

— E pse, — tha xha Rakua, — a s'e kam kryer mirë detyrën, a u kam turpëruar ndonjëherë?

— Jo, xha Rako, jo! — i tha komisari, — ti je njeri i ndershëm, ti je trim, ne me ty mburremi, por rruga sa vjen dhe bëhet më e vështirë, dimri është shumë i ashpër dhe ti je dobësuar. Ti e ke kryer detyrën shkëlqyeshëm, prandaj kthehu, xha Rako!

Xha Rakua në asnjë mënyrë nuk pranoi të kthehej. Ai ishte aq i vendosur për të vazhduar, sa që ishte e kotë të vazhdoje më tej.

Në mbrëmje Qemali u bë më keq dhe aty nga mezi i natës ai na dha lamtumirën e fundit, duke na porositur për të vazhduar rrugën tonë të gjatë, të vështirë, por të lavdishme.

E gjithë brigada u bë gati të vazhdonte marshimin drejt Veriut, për të goditur gjermanët në veri të qytetit Rudo dhe në afërsitë e Vishegradit. Ndërsa aty, në një fushë të vogël po rreshtoheshin partizanët e vegjël, pleqtë dhe robërit, që të ktheheshin në Shqipëri.

Në batalionin II xha Rakua përsëri e prishi qetësinë. Ai nuk donte të kthehej. Çështjen përsëri e zgjidhi komisari i brigadës, i cili u afrua afër turmës dhe ju drejtua xha Rakos:

— Xha Rako, pse nuk niseni me kolonën tuaj?

i tha komisari. — A e dini urdhërin se ju duhet të niseni para nesh?

— Shoku komisar! — tha xha Rakua.

Por komisari e ndërpreu dhe ju drejtua përsëri:

— A e dini ju se jeni caktuar përgjegjës i robërve? Kush do t'i çojë ata në Shqipëri? A e kuptoni se edhe kjo është një detyrë e rëndësishme? Po në rast se dezerton ndonjë rob kush do të përgjigjet?

Xha Rakua prej atij çasti nuk kundërshtoi më, por u drejtua nga mitralozi i tij dhe me lot në sy e puthi atë, puthi me respekt «Picirrukun», komisarin e batalionit e të gjithë me radhë dhe së fundi ndërroi me grusht komisarin e brigadës. Pastaj edhe një herë u kthye nga turma dhe tha: «Përpara shokë drejt Berlinit!» Komisari i brigadës, pasi e përqafoi, e porositi dhe i uroi rrugë të mbarë. Xha Rakua u vu në krye të karvanit të tij me sy të përlotur dhe me patickën krahëqafë.

Në drejtim të kundërt ecnin dy kolona: kolona e madhe që shkonte drejt Veriut me këngë në gojë, me flamurin dhe ballin lart dhe kolona e vogël që shkonte drejt Jugut, e sigurt se shokët do të mbërrinin deri në Berlin dhe do të plotësonin dëshirën e tyre.

MAJA E SUHAGORËS DHE KOMISAR FARI ZAIMI

Batalioni II ju afrua gjermanëve dhe u hodh në sulm drejt majave të Suhagorës (Vishegrad).

Partizanët u hapën në formacion luftimi përpara kësaj maje gjysmë të zhveshur dhe të mbuluar me borë.

Suhagora ndodhet në jug dhe në juglindje të qytetit Vishegrad. Ajo majë gjysmë e zhveshur të duket sikur zotëron mbi majat e tjera. Në të vërtetë ka tri lartësi, të cilat i qëndrojnë si kurorë qytetit të Vishegradit. Midis këtyre lartësive zotëron lartësia 975 metra. Mbi një lartësi të tillë janë zhvilluar luftimet më të ashpra. Këtu çdo pëllëmbë tokë është lyer me gjak shqiptari.

Më në jug të malit të Suhagorës vazhdojnë maja të tjera, madje më të larta se Suhagora. Këto arrijnë deri në Ducullova-Varda në thellësi drejt lartësisë 1235 metra.

Për t'i shkëputur forcat gjermane që mbroeshin në këto maja u sulmua qafa midis malit të Suhagorës dhe lartësisë 1066 metra, ndërmjet katundeve Meshinici dhe Belajke,



Lufta tani vazhdonte në front të rregullt. S'kishte më çetnikë, kishte vetëm gjermanë, fronti i tyre fillonte që nga katundi Drinos, para malit të Suhagorës, në lokalitetin Dobrun, më tej në qytetin Uzhicë, derisa lidhej me Ushtrinë e Kuqe.

Në krahun e majtë sulmoi kompania III e batalionit II. Por lufta më e ashpër u zhvillua në krahun e djathtë, në drejtim të lartësisë 1066 metra.

Një qendër zjarri e armikut në qafë rezistonte me këmbëngulje. Megjithëse dy partizanë i dolën asaj në krah dhe po e godisnin me granata, ajo përsëri vazhdonte të rezistonte. Gjermanët kundërsulmuan po në atë drejtim nga ana e pyllit. Por të dy partizanët që kishin zënë pozicion të favorshëm, megjithëse po rrezikoheshin të rrethoheshin dhe megjithë thirrjet e shokëve për t'u tërhequr, rezistuan deri në fund. Një tufan i përzier me mjegull mbuloi qafën. Partizanët përfituan nga ky rast për t'u ardhur në ndihmë shokëve të rrethuar.

Ata e zhvilluan mësymjen edhe më tej.

Armiku la shtatë të vrarë, dy mitralozë. 5 pushkë dhe një sasi municionesh.

Në krahun e djathtë kompania I, e komanduar nga komandanti trim Ethem Xhani, mbasi e shpartalloi armikun plotësisht, kishte zënë derën e një fortine dhe i «ftonte» gjermanët të dorëzoheshin.

Gjermanët as që e prisnin këtë sulm kaq të befasishtëm atë mbasdite, në atë borë aq të madhe, në atë të ftohtë. Ata ngroheshin brenda dhe po bisedonin për fatin e tyre, për fatin e familjeve, për fatin e «Gjermanisë së madhe».

Flamuri i bardhë u duk në dritaren e pozicionit të nëndheshëm dhe Harun Ahmeti nuk nguroi t'u hapte derën, dhe t'i nxirrte përjashta.

Një gjerman kërkonte të merrte diçka. Në kohën që partizanët sulmuan atij i kishin rënë për tokë fotografitë e familjes së tij. Në një fotografi dukej gruaja e tij, një flokëverdhe, e cila kishte dalë në oborrin e shtëpisë bashkë me djalin e saj, ndërsa në një fotografi tjetër ishte një vajzë e vogël, e mbështetur mbi një dru pranë murit të shtëpisë dhe që mezi dallohej nga bora.

— Merri! — i tha Haruni gjermanit, i cili si hiqte sytë nga gryka e automatikut.

— Sa shumë i duan dhe interesohen për fëmijët e tyre, ndërsa fëmijët tanë i vranë, i dogjën, diku i lanë jetimë dhe s'u erdhi keq!

— Nisini për në shtab! — urdhëroi Ethem.

Lufta vazhdoi deri natën vonë, gjermanët u tërhoqën në gjithë vargun e kodrave. Vetëm maja e lartë e Suhagorës nuk ra në duart e partizanëve.

Të nesërmen përsëri vazhdoi sulmi. Në krahun e djathtë dy kompani ecnin aq përpara sa dolën në katundin Zanosnjë. A ishte planizuar sulmi në këtë drejtim apo rastësisht partizanët sulmuan këtë vend, nuk dihej. Një gjë ishte e sigurt, që gjermanët ishin sulmuar në pikën më të dobët. Që në të shtënat e para ata u thyen dhe partizanët pa vështirësi dolën deri në Qafën e Zanosnjës. Sulmi i mëtejshëm nuk u bë për arsye se gjermanët kishin organizuar një mbrojtje shumë të fortë me transhe e hendeklidhje, me qendra zjarri të përhershme e të përkohshme të mbuluara me drurët e pishave shekullore.

Sulmi më i ashpër u zhvillua në drejtim të majës së lartë të Suhagorës. Që në fillim u vunë në përdorim bombat e dorës. Të ftohtit ishte i madh, bora tani e kalonte metrin dhe e pengonte sulmin e partizanëve. Por ata, ashtu si kurdoherë duke

thirrur «Përpara partizanë!», sulmuan drejt majës dhe e muarën majën e Suhagorës me përjashtim të një qëndre zjarri në skajin verior. Në këtë mënyrë tri anë të majës i mbanin partizanët dhe një anë gjermanët. Duhej të merrej patjetër kjo qëndër zjarri për të rënë plotësisht në duart tona kjo majë e lartë e qytetit të Vishegradit.

Komisari i kompanisë Fari Guçe Zaimi qëndronte në vijën e parë të zjarrit dhe ishte gati të sulmonte përpara. Ai u nis drejt qëndrës së zjarrit, por zëvendëskomandanti i batalionit nuk e lejoi.

— Jo!, —tha ai, — s'është nevoja të shkosh ti gjithnjë, ti je i lodhur! Edhe Seit Latifi shoku i tij më i afërt, zëvendëskomandant kompanie ashtu i tha, madje ai u nis vetë me një grup partizanësh drejt qëndrës së zjarrit.

Kur grupi partizan ju afrua objektit, armiku hapi zjarr jo vetëm nga qendra e zjarrit që ishte diktuar, por edhe nga një qëndër zjarri tjetër e vendosur poshtë në qafën që lidhte lartësinë 975 metra me majën e Suhagorës. Dukej që qendrat e zjarrit mbulonin njëra-tjetrën.

Luftimi vazhdoi gjatë. Qendra e zjarrit ruhej mirë dhe ishte vështirë t'i afroheshe. Por Seit Latifi, një nga luftëtarët më trima, u sul drejt duke thirrur: «Përpara, partizanë!», por u godit rëndë dhe ra.

Vrasja e Seitit dhe plagosja e dy partizanëve i dëshpëruan partizanët e tjerë që donin me çdo kusht ta merrnin këtë majë. Edhe komisar Fariu u dëshpërua shumë. Ai ishte shok i tij, bashkëfshatar. Qysh prej kohësh i kishin dhënë besën njeri-tjetrit. Sa vuajtje, mundime e luftime kishin kaluar së ba-

shku, ndërsa tani Seiti ra përpara syve të tij në majën e Suhagorës.

Komisari duke menduar se po të mos asgjësohej ajo qendër zjarri, nuk mund të sigurohej ecja përpara, madje as mbajtja e majës së lartë, mbasi u mendua disa minuta në këmbë, pa u vënë re nga të tjerët, përgatiti granatat, mbushi automatikun dhe u nis vetë në ndihmë të shokëve drejt fortinës, ju afrua asaj rrëshqitas, i mbuluar me kapotën e bardhë (nga bora). Në këtë mënyrë ai mundi t'i afrohej aq shumë qendrës së zjarrit, sa që të gjithë patën frikë se mos gjermanët do ta diktónin dhe mjaftonte një plumb ose një bombë për të larë hesapet me të.

Të gjithëve nuk u erdhi mirë që komisari u shkëput me vetëdijë drejt fortinës, megjithatë, ata ndiqnin me tension veprimet e tij. Për një çast ra heshtje. Por ai u çua përnjëherësh dhe hodhi njëra pas tjetrës pesë granata mbi frëngjinë e qendrës së zjarrit, e cila për një kohë heshti. Partizanët e tjerë u hodhën drejt saj dhe e mbuluan atë me granata.

Qendra e zjarrit u asgjësua plotësisht. Të gjithë gjermanët që ishin brenda u vranë dhe kompania vazhdoi përpara.

Pa mbërritur ende në qafë, gjermanët kundërsulmuan përsëri. Artileria e tyre rrihte pa pushim majën e lartë të Suhagorës.

«Asnjë hap mbrapa!» — urdhëroi komisari i batalionit III. Dyluftimi vazhdoi gjatë. Gjermanët kërkonin me çdo kusht të rimerrnin malin e Suhagorës, ndërsa partizanët tanë trima donin që jo vetëm të thyenin kundërsulmet e tyre, por të pushtonin majën tjetër më të ulët në veri të saj.

U ndez një luftim i pabarabartë — një kompani

me 40 partizanë luftonte me një batalion gjermanësh prej 400 vetësh, që mbështetej me artileri e mortaja.

Nënkomandanti i batalionit III që u erdhi në ndihmë, u përlesh me ta dhe i detyruan gjermanët të thyhen. Por përsëri sulm dhe përsëri përleshje fyt më fyt me ta. U vranë partizanët Refat Bajrami dhe Shaban Malo, u plagos Rushit Dervishi, Jashar Sherifi dhe Hamit Goga.

Lufta vazhdonte. Në ballë të tyre qëndronte komisar Fariu. Të gjithë kthenin kokën nga Fariu, ndoshta ndonjëri mendonte se duhej të tërhiqeshin, por komisari e kishte menduar mirë se kjo majë nuk duhej të lëshohej, se po të merrej përsëri nga gjermanët, do të kërkohej mjaft gjak tjetër për t'u rimarrë.

Vendi ku qëndronin partizanët ishte gjakosur, bora ishte skuqur, por trimat mbaheshin. Gjermanët përsëri sulmuan me forca edhe më të mëdha, pre-dhat e artilerisë së tyre e kishin bërë pllajën e bukur me njolla të zeza, bloza i kishte nxirë disa në fytyrë, disa të tjerëve ju ishin shkaktuar plagë të lehta.

— Kurseni municionin! — urdhëroi komisar dhe përsëri u ndez lufta me granata. Fariu qëllonte e qëllonte. Gjermanët e panë se pa u asgjësuar grupi i Fahriut nuk mund të ecej përpara, prandaj gjithë zjarrin e përqëndruan mbi grupin e komisarit.

Në përleshjen e fundit komisar u godit rëndë. Ai, megjithëse mori një plagë në kraharor, prapë vazhdoi të qëllonte. Me një dorë mbante gjakun dhe me tjetrën qëllonte.

Vrasja e komisarit i bëri partizanët që t'i go-

ditnin më me tërbim gjermanët dhe t'i detyronin ata të thyeshin.

E çuan komisarin në majën e lartë dhe e zbërthyen për t'i lidhur plagën.

— Mos më trazoni! — tha komisar i dhe hodhi sytë nga jugu për të kërkuar midis majave të larta majën e Tomorit, rrëzë të cilit ai kishte kaluar të ritë e tij. Aty ai dha shpirt duke thirrur: «Të rrojë partia!» «Përpara, shokë, drejt Berlinit!»

Komisar Fariu dhe shokët e tij u vranë, por mali i Suhagorës nuk ra në duart e gjermanëve. Atë e mbronin me çdo kusht shokët e Fariut që nuk e lëshuan deri në fund.

BASHKËVEPRIMI

Armiku në qendrën e banuar Dobrun dhe malet
i Suhagorës u thye. Lufta vazhdonte më në thel-
llësi. Në krahun e majtë mësynin brigadat VI dhe
VIII shqiptare, ndërsa në krahun e djathtë të Bri-
gadës VII dhe pikërisht të batalionit II sulmonte
Brigada V sanxhake (jugosllave).

Për t'u ndërlidhur me Brigadën V sanxhake u
ngarkua batalioni II. Atje shkuan komisar i bata-
lionit shoku Bajram Rodeshi, zëvendëskomisari i bata-
lionit, Sulo Gradeci, komandanti i kompanisë II,
Nevruz Gjëbësi dhe një partizan.

Si vijë kufitare midis dy brigadave shërbente
lumi Zav¹⁾. Grupi i bashkëveprimit, mbasi kaloi
këtë lumë, arriti në afërsi të shtabit të tyre, i cili
ishite vendosur te disa shtëpi matanë një kodre.

— Stoj! (Ndal!) — u dëgjua zëri i rojes jugos-
llave. Të gjithë qëndruan.

— O stali stoj jedan napret! (Të gjithë në vend.

1) Arkivi Qendror i Ushtrisë, Fondi Brigada VII, Dosja
Nr. 4.

një përpara). Përpara shkoi Sulua. Mbas u dha sqarimet e rastit përgjegjësit të rojeve, u nis në drejtim të shtabit.

Përgjegjësi i rojeve një nënoficer që kishte vënë rrip mesi dhe që i armatosur me një pushkë sërbe dhe me një pistoletë gjermane, herë shikonte përpara dhe herë ndalonte. Ai i pyeste shokët për çdo gjë, për luftën, për veshjen, për ushqimin, ai dukej njeri shumë i mirë, shumë i thjeshtë.

— Admirojmë luftën e partizanëve tuaj! — ju drejtua ai komisarit.

— Ju faleminderit! — ju përgjegj komisarit. Ata së largu, por përballë kishin vrojtuar luftën që kishin bërë partizanët tanë për 4-5 ditë me radhë. Marja e malit të Suhagorës dhe mbajtja e tij u kishte bërë atyre shumë përshtypje.

— A ishte ndonjëri nga ju në atë majë? — pyeti nënoficeri.

— Po — ju përgjegj komisarit.

Por ai edhe në këtë rast shikonte partizanët dhe kthente kokën nga mali i lartë, ndoshta përfytyronte partizanët që kishin sulmuar atë majë. Sa më tepër partizanët i afroheshin grupit të shtëpive aq më shumë partizanë grumbulloheshin për të shprehur dashurinë dhe respektin e tyre për partizanët shqiptarë.

Por komisarit ndaloi dhe i tha përgjegjësit të tyre:

— Na çoni më shpejt në shtab se kemi punë!

Të shoqëruar me përgjegjësin e rojeve, grupi ynë hyri në shtab.

Sa u hap dera komisarit dhe shokët e tij përshëndetën:

«Smert fashizma!» («Vdekje fashizmit!»)

«Sllaboda naroda!» («Liri popullit!») u përgjegjën disa prej tyre, të cilët vazhdonin të luanin një lojë që partizanët s'e kishin parë ndonjëherë.

Komisari jugosllav, së bashku me shokët e tij, u interesua për t'ju dhënë shokëve ushqim dhe për të ngrënë së bashku me ta. Ata ndenjën dhe biseduan si shokë armësh.

U muarën vesh mbi sulmin e të nesërmes, mbi drejtimin e mësymjes, mbi objektivat që do të arrinin, mbi sinjalet dhe mbi orën e sulmit. Megjithatë qëndrimi indiferent i komandantit nuk i pëlqente shokëve tanë.

Mbas pak grupi u ngrit dhe, mbasi u përshëndet, u largua për në katundin Zanosnjë, duke shprehur dëshirën për të hyrë së bashku në qytetin e Vishegradit.

Sulmi filloi në orën e caktuar. Partizanët e Brigadës VII luftonin pa pushim në vargun e kodrave të qytetit të Vishegradit. Batalioni II eci përpara, mori grupin e tri shtëpive mbi xhadenë Dobrun-Vishegrad dhe arriti deri te shkëmbi i Zagres, por aty u ndal nga zjarri i kryqëzuar që vinte nga përtej lumit. Brigada sanxhake hapi zjarr të dendur mbi armikun, por shpejt sulmi i tyre u ndal. Se për çfarë arsye ndodhi kjo s'e morëm vesh. Nga ana jonë lufta vazhdoi për një orë të tërë dhe në fushën e betejës ranë heroikisht shokët Gori Vangjeli, Hazi Demiri, Xhemal Malaj, Jani Mita, Stavri Kristo etj. Ndërprerja e sulmit tërhoqi vëmendjen e partizanëve. Disa shokë shprehën keqardhjen e tyre për këtë bashkëveprim të pakoordinuar. Për këtë komanda e batalionit dhe më vonë komanda e brigadës i drejtoi një raport me shkrim komandës së divizionit me shkresë Nr. 34/13 datë

7.2.1945¹⁾, ku vihej në dukje se forcat e Brigadës V sanxhake e prenë sulmin, sigurisht këtu nuk ishte fjala se ata e bënë këtë me qëllim, por këtu dukej puna pa përgjegjësi e komandantit të brigadës sanxhake, i cili u tregua i papërpiktë dhe jo konsekuent.

Në këtë kohë kudo ushtria jugosllave e godiste pa ndërprerje ushtrinë fashiste dhe marshonte përkrah Ushtrisë së Kuqe.

Sulmi i datës 5 shkurt ishte mjaft i ashpër. Të gjithë sulmuan me guxim për të hyrë në qytetin e Vishegradit. Kompanitë e skalionit të parë mbërritën deri në portat e qytetit. Përsëri nga ne ranë duke luftuar shokët Dane Shurdiu, Alush Ibrahim, Thimi Tani etj. dhe u plagosën shokët Selim Xhele, Qemal Cema, Jonuz Qamili, Nevruz Qazimi, Haxhi Hasani.

Sulua shkoi përsëri për t'u ndërlidhur me shokët e shtabit jugosllav...

Në kodrën e parë përtej lumit në drejtim me grupin e tri shtëpive Sulua takoi një oficer të batalionit I të Brigadës V sanxhake, mbasi u përshëndet me të, Sulua e pyeti:

— Ku është komandanti?

— Nuk e dimë, — u përgjegj oficeri. Sakaq pranë grupit të vogël të partizanëve shqiptarë u grumbulluan mjaft shokë jugosllavë.

— Në qoftë se ju do ta kishit vazhduar sulmin nga kjo anë do të kishit hyrë patjetër brenda në qytet, — tha Sulua.

— Po, — tha oficeri duke ulur kokën, — por

1) Arkivi Qendror i Ushtrisë, Fondi Brigada VII, Dosja Nr. 2.

as ne nuk e kuptojmë pse komandanti dha urdhër për të ndaluar sulmin. Ne pamë me sytë tona sulmin e fuqishëm që bënë partizanët shqiptarë, ne u cuditëm kur ata u përleshën fyt për fyt me gjermanët dhe mbërritën deri në afërsi të lagjes së jashtme. Sukseset tuaja janë të dukshme; partia dhe shoku Enver paska kalitur me të vërtetë një ushtri trime!

— Ju faleminderit! — tha Sulua. — Ne po derdhim gjak për një qëllim të përbashkët dhe ky gjak duhet të mos shkojë kot. Ja, — dhe tregoi me dorë ato kodra përballë — atje tej u vranë me dhjetëra shokë nga tanët. Vishegradi patjetër duhet të bjerë në duart tona.

— Nuk e dimë pse nuk sulmojmë, — tha një partizan jugosllav, — as komandantin nuk e dimë se ku është.

— Por ne, — tha një tjetër, — në mëngjes do të sulmojmë patjetër qoftë edhe pa urdhër.

Fjalën e tij e pranuan të gjithë.

DREJT BERLINIT

Atë ditë forcat tona kishin ecur mjaft përpara në të gjithë vijën e frontit. Armiku ishte ngushtuar dhe tani mbrohej vetëm në periferi të qytetit, ku aty-këtu mbante ndonjë kodër.

Mbas luftimeve të plagosurit u dërguan në spital, ndërsa të vrarët u varrosën pjesërisht në Qafën e Zanosnjës, disa në katundin Zagre dhe disa në majën e Suhagorës. Mbi varret e tyre u mbajtën fjalime nga komandantët, komisarët dhe shokët më të afërt. Të gjithë premtuan se amanetin e tyre do ta çonin deri në fund, se gjaku i tyre nuk do të shkonte kot, por do të ishte simbol i lirisë dhe i luftës sonë. Disa shprehën keqardhjen ngaqë shokët e Brigadës V sanxhake nuk ndihmuan sa duhet në krahun e djathtë dhe si rrjedhim mjaft shokë u vranë nga zjarri anësor i armikut.

Në mbrëmje e gjithë lugina e Zanosnje-Zagres dhe ajo e lumit Zavra në heshtje. Dukej që të dyja palët ishin të lodhura.

Bora sa kishte filluar të pushonte dhe qielli po kthjellohej, frynte një erë e lehtë dhe bënte

shumë ftohtë. Pranë zjarrit ku rrinin partizanët e kompanisë II kishte heshtje. Vetëm aty-këtu dëgjo-heshin të kërciturit e shkarpave të pishave që digjeshin të njoma.

Dikë e kishte zënë gjumi me pushkë nën kokë, dikë me pushkë midis këmbëve dhe dikush kishte mbështjellë fytyrën me kapotë dhe po flinte. Aty pranë ngrohej dhe «Piciruku», i cili rrinte ulur me automatikun shtrirë mbi dy çapokët, me duar të lidhura midis gjunjëve dhe herë dremiste e herë zgjohej. Ajo natë për vetë ngjarjet që kishin ndodhur gjatë 24 orëve i ngjante një nate jo të zakonshme.

Komisari i batalionit e kishte bërë zakon që përpara se të flinte të kontrollonte rojet dhe të gjithë partizanët, se si i kishin zënë vendet. Ai ishte shumë i dashur me shokët, kurdoherë përpiquej t'i ndihmonte ata, bisedonte gjithmonë me ta. Por edhe ata e donin komisarin, e respektonin atë, dëgjonin këshillat e tij dhe zbatonin me përpikmëri urdhërat.

Sa herë që komisar i takohej me partizanët u fliste atyre për lajmet me rëndësi, për gjendjen politike, për të ardhmen.

Atë mbrëmje ai erdhi në atë rrëzë kodre pranë atyre zjarreve të zbetë dhe i përshëndeti partizanët:

— Vdekje fashizmit!

— Liri popullit! — ju përgjegj Vasili së bashku me disa shokë që ende s'i kishte zënë gjumi, por që asnjë fjalë nuk këmbenin me njëri-tjetrin. U ngritën në këmbë dhe secili e ftonte komisarin të ulej pranë zjarrit.

— E mor «Picirruk», a mërdhi? — ju drejtua ai partizanit të vogël.

— Jo, shoku komisar, nuk mërdhi!

Atë ditë partizani i vogël ishte shumë i mërzitur. Disa ditë më përpara atij ju vra komisar i afërt, njeriu me të cilin kishte kaluar të gjitha vështirësitë e luftës. Asnjëherë nuk ishin ndarë, kishin bërë me mjëra kilometra rrugë dhe në gjithë ato luftëra e përpjekje, nuk kishin pësuar asgjë. Por ata u ndanë këtu, në majën e Suhagorës. Komisar i kishte premtuar se kur të ktheheshin në Skrapar një javë do të qëndronin në shtëpinë e tij dhe pastaj së bashku do të shkonin në shtëpinë e partizanit të vogël.

Por përveç këtyre dhembjeve atij ju vra sot një shok tjetër. Ai ishte Ali Memetasi, një partizan i shkathët nga rrethi i tij dhe pothuaj moshatar me të. Për këtë arsye ai rrinte i veçuar, i mërzitur dhe pothuajse e kishte humbur torruan.

Mbasi këmbyen disa fjalë me komisarin, përsëri pranë zjarrit ra heshtje:

— Shoku komisar, na trego ndonjë gjë! — ju drejtua Vasili komisarit.

— Çfarë t'ju tregoj? — tha komisar.

— Ja, na trego kur mund të vemi në Sarajevo?

— Së shpejti, — tha komisar, këto 2-3 ditë duhet të hyjmë patjetër në qytetin e Vishegradit. Gjermanët me vështirësi po mbahen, pastaj edhe një sulm tjetër e në Sarajevo e kështu me radhe.

— Po deri në Berlin kur do të vemi vallë? — pyeti partizani i vogël.

— Posi edhe deri në Berlin do të vemi! — tha

komisari. Ushtria e Kuçe, ushtria e Stalinit po ecën përpara me shpejtësi. Sukseset e saja janë të mëdha. Ndërsa ushtria gjermane vazhdon të tërhiqet drejt Berlinit. Ajo çdo ditë po pëson disfatë.

Dita e fitores është ditë e shpejtë dhe ne do të kalojmë në Berlin si ushtri fitimtare.

— Sa e bukur do të jetë ajo ditë, shoku komisar, kur ne do të kalojmë krenarë në Berlin dhe t'i tregojmë gjithë botës se edhe Shqipëria ka luftuar dhe kontribuar për çështjen e përgjithshme, — tha Picirruku dhe vazhdoi:

— Po në Shqipëri a e marrin vesh si luftojmë ne këndeje?

— Të gjitha i marrin vesh, madje çdo ditë flet radjoja dhe dalin komunikata për të gjitha luftimet, — tha komisari.

— Po në Skrapar i marrin vesh?

— Po, mor shejtan, edhe atje, — i tha komisari duke qeshur.

Partizani qeshi dhe nuk foli më. Biseda vazhdoi deri vonë, ndërsa gryka me pisha herë pas here ndriçonte nga fishekët ndriçues dhe shenjdhënës që hidhnin gjermanët për të kontrolluar zonat e zjarrit nga frika e ndonjë sulmi të papritur partizan.

Komisari foli gjatë, ai tha se kjo është një luftë për jetë a për vdekje që kërkon ende sakrificë përderisa të mos ketë këmbë fashisti, përderisa të mos ketë shfrytëzues dhe të shfrytëzuar.

Mbasi këmbyen disa shaka me komisarin, ai u largua dhe përsëri ra qetësia, por tani partizanët ishin më të ngrohtë nga fjalët e tij dhe shpresonin se së shpejti do të ecnin përpara drejt Berlinit.

Komisari kaloi sa te një zjarr në tjetrin dhe me punën e tij i ndihmonte partizanët për të mbajtur lart moralin e tyre, por partizanët të bindur e të vetëdijshëm për luftën e tyre ishin të gatshëm për çdo sakrificë. Të ftohtit, mungesa e veshmbathjes, e ushqimit dhe e armatimit nuk e ndalnin sulmin e tyre; ata ishin të gatshëm të shkonin deri në Berlin.

SULMI I FUNDIT

Kishte tri ditë që binte borë e madhe. Edhe ato pak shenja që kishin lënë luftimet e disa ditëve të mëparshme edhe ato ishin zhdukur. Në qoftë se aty-këtu dukej ndonjë copë transheje ose nxintendonjë dritare fortifikate, më 4 shkurt të vitit 1945 të gjitha njollat e zeza nuk dukeshin më, ato ishin mbuluar nga bora e madhe. Pemët dhe pyjet me pisha ishin varur shumë nga pesha e borës, disa prej tyre ishin thyer.

Filloi pregatitja për sulmin e datës 5 shkurt 1945. Thoshin se ky ishte sulmi i përgjithshëm.

Tom Karadaku, komandanti i kompanisë, ishte shumë i sëmurë. Ai ishte mbështetur pranë një sobe në një dhomë të një fshatari dhe nuk mori pjesë në pregatitjen për sulm.

Kompania u nis dhe ai me lot në sy mezi arriti deri te dritarja për t'i parë edhe një herë shokët e tij që po niseshin për këtë betejë të vështirë.

— T'ju afroje pranë zjarrit? — e pyeti partizani që ishte caktuar t'i shërbente Tomit.

— Jo, — tha Tomi, — mos më trazo!

Partizani mori kapotën, ja hodhi krahëve dhe nuk e trazoi më. Tomi prej natyre dukej pak i rëndë dhe në qoftë se vendoste për diçka ishte e kotë ta kundërshtojë.

Aty te kthesa e fundit një partizan u zhyt në borë dhe Tomi që ndiqte veprimet e tyre rënko i thellë. Por ja, partizani u ngrit përsëri dhe kolona u zhdruk në mjegullën e bardhë.

Tomi shtrëngoi fort parmakët e dritares dhe tha:

— Kushedi se si do të shkojnë luftimet sot! Sa të vështirë do ta ketë komisari në atë vend të zhveshur, të mbuluar me borë!

Ishte hera e parë që Tomi nuk merrte pjesë në sulm dhe për këtë arsye ai ishte dëshpëruar shumë. Ai mendonte se prania e tij si më i mosshuar do të lehtësonte veprimet e shokëve të tij. Po ku do të shkonte ashtu i sëmurë? Gjunjët i ishin prerë, fuqitë po e linin. Ai ndenji i varur mbi dritare, me kokë të mbështetur te dora, derisa i ra të fikët. Partizani përsëri e afroi pranë zjarrit duke e mbështjellë me një kapotë dhe me një batanie.

Vija e frontit prej andej nuk ishte larg dhe ai po priste të dëgjonte krismën e armëve të divizionit shqiptar, i cili do të hidhej i tëri në sulm.

Mbas mesit të natës të gjitha repartet ishin pregatitur për sulm, prisnin vetëm urdhërin. Sinjali u dha. Që nga lindja e deri në perëndim filloi një betejë e vërtetë: kudo flakë, tym dhe krisma.

Tomi përsëri nën dritën e atij kandili të zbetë filloi të hiqej zvarrë te dritarja dhe aty u mbështet përsëri për të vrojtuar.

— Pse nuk rri shtrirë shoku komandant? Si ju porositi komisari i brigadës? A e kuptoni ju se në

këtë mënyrë do të sëmureni më keq? — ju drejtua partizani.

Tomi i mbështetur në kanatet e hapura të dritares pa e shkëputur vëmendjen nga fusha e luftimit, as që ju përgjegj fare pyetjeve të partizanit.

Nga dritarja ku qëndronte ai, vrojtoheshin më mirë veprimet e batalionit II dhe IV, prandaj ai hidhte sytë sa në një anë në tjetrën. Krismat sa vinin e shtoheshin, ato përziheshin me zhurmën dhe plasjet e predhave të artillerisë gjermane.

Tomi ju drejtua partizanit:

— Nuk kam parë luftë kaq të madhe!

— Edhe mua ashtu më duket, shoku komandant! — u përgjegj partizani. Me fillimin e luftimeve të gjithë njerëzit janë në tension, por mbasi mbarojnë bataretë e para, bëhen më të matur, më gjakftohtë.

Partizani u afrua pranë dritares. Në këtë kohë një predhë artilerie fishkëlleu mbi shtëpinë e mbuluar me dërrasa dhe plasi përtej në pllajë.


— Ulu poshtë! — i tha Tomi partizanit. — Zbrit poshtë shkallëve!

Por partizani nuk ju bind.

— Unë, — tha ai, — kam si detyrë të rri me ju, prandaj mos u shqetësoni për mua, shoku komandant!

Ndërsa Tomi dhe partizani vrojtonin nga larg, në lartësinë 975 metra, në kodrat e Toleshit dhe të Zagres vazhdonte pa pushim një luftë e parë rrallë në historinë e Brigadës VII.

Kompania që udhëhiqte komisari i ri Thimi Tani çau përpara. Ajo, duke përfutur nga goditja në befasi, i doli në krah shkëmbit të Zagres dhe u fut thellë në pyll. Luftimi në krahun e majtë të lumit Zav



Dëshmori Thimi Tami

vazhdonte me sukses, ndërsa nga krahu i djathtë. pikërisht nga ana që sulmonin jugosllavët, krismat kishin filluar të rralloheshin. Po kalonte dreka e kësaj çete ndërsa partizanët jugosllavë nuk ecnin më përpara.

Mbasdite u ndez një luftë e ashpër. Në drejtim të pykëzimit të batalionit II gjermanët filluan një kundërsulm të shoqëruar me goditje artilerie dhe me zjarr thike nga përtej lumit. Pështa më e rëndë i ra kompanisë së Thimit, të këtij komunisti me moshë të re nga qyteti i Beratit, i cili qëndroi heroikisht, luftoi si trim dhe udhëhoqi kompaninë më së miri.

Kompania jo vetëm që i rezistoi sulmit të gjermanëve, por kjo u mundua të ecte përpara për të kapur kodrën e fundit të qytetit të Vishegradit. Aty lufta vazhdoi e rreptë, pengesat prej teli, minat dhe fortifikatat nuk i ndalën partizanët.

Në këto luftime tregoi trimëri të rrallë dhe luftoi ashtu si u ka hije atdhetarëve tanë, trimi Nexhat Hysa, i cili u hodh me guxim në llogoret e gjermanëve dhe u vra.

Kompania goditej jo vetëm nga përpara, por edhe nga ana e lumit. Për shumë kohë asaj ju desh të rrinte e shtrirë në borë pa lëvizur për orë të tëra. Nga kjo arsye shumë shokë u sëmurën, ndërsa disa të tjerëve u ngrinë këmbët.

Komisar Thimi mbeti në një situatë të vështirë. Nga krahu i djathtë gjermanët përparonin përtej lumit; kompania e tij rrihej me zjarr të dendur dhe përballë sulmi ishte dhe më i ashpër. Me komandën e batalionit lidhja ishte prerë, të plagosurve duhej t'u vihej në ndihmë.

Partizani Faik Myftari, i cili mundi të arrinte deri te Thimi, i dha një letër, ku shkruhej: «Mundohu të tërheqësh kompaninë nga luftimi!».

Thimi la një skuadër që të ndalte për një kohë gjermanët, që të mos zinin majën e shkëmbit. Një grup me një mitraloz e caktoi të mitralonte forcat gjermane, që po dilnin në krah, ndërsa të tjerët i urdhëroi të tërhiqeshin drejt grupit të tri shtëpive. Vetë qëndroi me një mitraloz për të mbajtur me zjarr ekuilibrin midis atyre që luftonin dhe midis atyre që tërhiqeshin. Kur u pa se gjendja po vësh-tirësohej më tepër, ai e mori vetë mitralozin dhe u dha shenjë të gjithëve të tërhiqeshin. Me të qëndruan vetëm dy partizanë.

Shembulli personal ishte bërë masiv në kuadrot e Brigadës VII partizane, sidomos që nga Operacioni i Qershorit dhe këndeje. Shumë kuadro shkonnin në vijën e parë të zjarrit. Pati edhe nga ata që dhanë jetën e tyre si Gani Nivica komandant batalioni, Skënder Libohova komisar batalioni, etj.

Disa herë vetë shokët e shtabit si A. Çarçani, R. Alia, N. Hysi, K. Myzeqari, M. Fuga, N. Dem, M. Daci, Q. Kapisyzi e të tjerë jo vetëm që udhëhoqën luftimet por muarën pjesë drejtpërdrejt në vijën e parë të zjarrit në Brobonik, Berat, Lushnjë, Belsh, Mirditë, Lezhë, Berdic, Shkodër, në Mal të Zi, në Vishegrad.

Ishte kritikuar disa herë se nuk ishte e domosdoshme që kuadrot të shkonin në vijën e parë, por a mund t'i ndaloje atëhere komandantët dhe komisarët? Vetëm Brigadës VII përtej kufirit ju dëmtuan dhjetë komisarë, nga të cilët ishin shtatë të vrarë dhe tre të plagosur. Me ta kishin punuar dhe luftuar së bashku shokët Adil Çarçani, Ramiz Alia;

vazhdonin të punonin shokët Qazim Kapisyzi dhe Kol Myzeqari, që kishin ngjallur te kuadrot dhe te i gjithë efektivit dashurinë për partinë, për komandantin tonë, për popullin tonë, kishin farkëtuar urtësinë, trimërinë dhe heroizmin.

Kur shtabi i batalionit II pa se kompania I u përgjak rëndë, dërgoi në ndihmë disa partizanë të udhëhequr nga zëvendëskomandanti i batalionit Sullo Gradeci, të cilët u dhanë një grusht të mirë gjermanëve në rrezë të pyllit dhe arritën deri tek ata.

Thimi me mitraloz, kishte vrarë mjaft gjermanë, por edhe ai kishte marrë disa plumba. Kokën e kishte mbështetur mbi mitraloz dhe flokët e tij gjysmë të verdha i kishin filluar t'i ngrinin. Nga gjoksi i tij vazhdonte të rridhte ende gjak.

Vrasja e komisar Thimi Tamit që e papritur për partizanët. Ata nuk e besonin, shpresonin se ai do të kthehej, ashtu siç shpresonte edhe Tom Karadaku, i cili e njihte shumë mirë këtë komisar të ri trim e gjakftohtë. Por Thimi s'u kthye më.

Tom s'i hiqte sytë nga lartësia 975 metra. Nga dritarja ai dalloi atje larg se në një shtëpi po strehoheshin disa partizanë që mbanin në kurriz disa të tjerë. E kuptoi si ishte puna, por donte të dinte në ishin të vrarë apo të plagosur. Aty në qafë, në krye të një are pranë një peme të vetmuar ai dalloi disa partizanë që po hapnin gropa dhe disa grumbuj partizanësh të tjerë që bisedonin...

Cfarë kishte ndodhur?

Çelësi i të gjitha lartësive të tjera ishte lartësia 975 metra. Aty sulmoi batalioni IV. Batalioni mundi të pushtonte një kodër në krahun e djathtë, por në krahun e majtë ai nuk pati sukses. Partizanët

u hodhën në sulm me bomba dore, ndërsa gjermanët u përgjegjën me zjarr të dendur dhe të organizuar mirë.

Kompania III me në krye skuadrën automatikëse u përlesh në majën e lartë dhe arriti deri përpara fortifikatave kryesore. Ajo aty u ndalua për arsye se gjermanët kishin organizuar pengesa të ndryshme. Dita agoi dhe lufta përsëri vazhonte. Aty u vranë dy partizanë, u plagos dhe më vonë vdiq Hamit Selman Meta nga katundi Mjedë i Shkodrës dhe u plagos rëndë Tajar Xhaferi — komandant i skuadrës automatikëse, sot invalid i Luftës nacionalçlirimtare,

Gjermanët në krahun e majtë të lartësisë 975 m. kishin organizuar dhe ekspozimin e dordolecave gjermanë. Këtë e bënë me qëllim që partizanët zjarrin e tyre ta përqëndronin mbi këto silueta, të mbaronin municionin dhe të dilnin përpara fortinave të heshtura.

Në disa raste dordoleci për shumë kohë nuk ulej.

— Po si nuk u vritka ky gjerman, ore? — i tha Vasili Pandit, një partizani myzeqar me trup të madh.

Megjithëse distanca nuk i kalonte të 100 metrave dhe Vasili ishte i sigurtë se plumbat e përshkonin trupin e gjermanit, ai përsëri çuditej si dilte përsëri gjermani kur ai e qëllonte.

Në këtë kohë një krismë u dëgjua nga një llogore anësore dhe Vasili vështroi mitralozin e tij të çarë. Pandi ju afrua me shpejtësi dhe doli në drejtim të gjermanëve, të cilët vazhdonin lojën e tyre. Një tjetër e shtënë dhe kapela e Pandit u shpua tejprtej. Në këtë kohë një partizan tjetër

qëlloi në drejtim të gjermanit, por i sigurtë në të shtënat e tij, vetëm dy herë qëlloi dhe kur pa se gjermani nuk u ul ai u tha shokëve të tij: «Ai është gjerman i vrarë ose siluete gjermani që e nxjerrin ata për të na goditur ne».

Në këtë mënyrë atyre nuk u shkoi më hileja.

Në krahun e djathtë lufta vazhdonte më e rreptë. Aty u vranë duke luftuar heroikisht shokët Kici Laçka, Lake Skrevani dhe Zylfo Rajani. Por më e keqja ishte se municioni po mbarohej. Lufta kishte më tepër se dhjetë orë që vazhdonte pa pushuar. Ishin vrarë me qindra gjermanë.

Kur pa komanda e batalionit se detyra ende nuk ishte plotësuar ajo la disa partizanë për të bërë zjarr në mbrojtje dhe në të gjitha kompanitë u bë mbledhja e komunistëve.

Në mbledhje u diskutua si mund të plotësohej detyra në ato kushte dhe si të vepronin komunistët me ato pak municione që ju kishin mbetur.

Në të gjitha celulat e batalionit IV u muar një vendim i vetëm me këto tri pika:

a) Të sulmohej armiku në pika të veçuara, në vendet më të dobëta të tij.

b) Të sulmohej armiku në ato pika të dobëta me jo më tepër se 10-15 shokë të zgjedhur për çdo kompani.

c) I gjithë municioni të grumbullohej në duart e atyre shokëve të zgjedhur që do të kryenin sulmin.

Si zakonisht pati diskutime në caktimin e shokëve që do të merrnin pjesë në sulmin vendimtar. Më në fund u caktuan disa shokë dhe u vendos që pjesa tjetër e shokëve që mbetën do të sulmonin radhën tjetër kur të vinte municioni. Ishte e vështirë atëherë të bëje dallime.

Katër grupet e sulmit në Qafën e Zanosnjës u ndanë dhe secili mori drejtimin e tij. Në vendin më delikat sulmonte grupi i sulmit, i komanduar nga komandanti i kompanisë III Neki Muka. Njëmbëdhjetë shokët që përbënin grupin rrëshqitën drejt përroit të vogël për ta sulmuar lartësinë 975 metra nga krahu i djathtë.

— Zhytuni të gjithë në borë! — urdhëroi Neki. Partizanët u zhytën, u bënë të gjithë të bardhë dhe të maskuar vazhduan ecjen drejt gjermanëve.

Aty ku vendi ngushtohej dhe ishte i zbuluar. Neki urdhëroi që të rrëshqisnin një nga një në distancë pesë metra nga njëri-tjetri.

Të gjithë rrëshqitën pa vështirësi pas Nekiut aty ku rruga ngushtohej, bora e bardhë ishte skuqur nga gjaku i shokëve që ishin vrarë e plagosur në mëngjezin e asaj dite.

Neki për një çast ndaloi. Bora e përgjakur i kujtoi përsëri shokët e rënë. Hodhi sytë rreth e qark, psherëtiu thellë dhe kur, pa se të gjithë e ndiqnin, vazhdoi përpara, derisa mbërriti te takimi i dy përrenjve të vegjël.

Kur grupi u mblodh në këtë vend vunë re se me ta ishte bashkuar dhe komisar i batalionit.

Komisari ishte i një mendimi me Nekiun që sulmi të bëhej i befasishëm dhe i ndarë më treshe. Një grup do të sulmonte drejt fortifikatën e nëndheshme, një grup tjetër fortifikatën në të djathtë, në drejtim të qafës dhe tjetri do të mbështeste në rast nevojë me zjarr.

Gjermanët mendonin se pas atij sulmi që vazhdoi natën dhe tërë paraditen partizanët nuk do të hidheshin më në sulm, prandaj ata ishin struktur dhe ngroheshin në strehimet e tyre.

Bënte shumë ftohtë. Temperatura ishte afër 20-25° nën zero. Vetëm roja gjermane u vrojtua në kodër, ndërsa më tej një roje tjetër përpiqte këmbët në tokë për t'u nxehur.

Grupi i komisarit shfrytëzoi një pemë të gjatë shekullore që ishte e rrëzuar. Ata rrëshqitën deri te kreu i saj dhe aty ndaluan për të parë veprimet e dy grupeve të tjera.

Deri në këtë kohë çdo gjë kishte shkuar për mrekulli, asgjë nuk ishte diktuar. Grupi i Nekiut u afrua aq afër rojes saqë u çuditën vetë se si ai nuk i shikonte. Edhe grupi tjetër u afrua afër qafës, dhe një mjegull e dendur që kishte rënë atë kohë ndihmoi veprimet e partizanëve. Grupi i Nekiut, mbasi u afrua jo më larg se pesë metra, e goditi rojen për vdekje dhe, pa u ndalur, u hodh në fortinë. Po në këtë mënyrë veproi edhe grupi tjetër.

Në fortinën ku hyri Neki, e cila në pjesën e mbrapme kishte një strehim për ekipazhin, asnjë gjerman s'kishte mbetur i gjallë.

Me rënjen e këtyre dy fortifikatave në vijën e frontit, u krijua një e çarë, të cilën partizanët e shfrytëzuan me mjeshtëri duke e krahëmarrë dhe shpënë marrë lartësinë 975 metra. Në këtë mënyrë grupi i sulmit, që kryesohej nga Vangjel Tiko e pati më lehtë për t'u hedhur në sulm. Gjermanët, të veshur me rroba të bardha, kundërsulmuan forcat partizane, por ata u kundërgoditën nga partizanët. Tre gjermanë njëri pas tjetrit u sulën drejt derës së fortinës, por partizani që bënte roje te dera i goditi ata dhe rrëzoi dy prej tyre.

Sulmi i partizanëve të këtij batalioni vazhdoi deri poshtë në luginën me pisha. Atje luftimet arri-

tën gati trup me trup. Nga ana jonë këtë radhë pati më pak gjak, u vra vetëm shoku Elmas Ibrahimmi dhe u plagosën disa të tjerë.

Në llogoret e gjermanëve u gjendën me dhjetëra gjermanë të vrarë. Ky ishte rezultat i sulmit të paradites, ndërsa tani mbasdite në fushën e be-tejës u gjendën më tepër se 40 të vrarë. Suksesi ishte i plotë, lartësia kryesore ra në duart e partizanëve dhe vija e frontit u shty deri në lagjet e qytetit. Me dhjetëra mitralozë, pushkë, automatikë, revolverë dhe çizme dorëzoi të nesërmen në shtabin e brigadës kompania III e batalionit IV.

Shoqja Vala Gjeçi, sekretare e celulës së kompanisë III të këtij batalioni, u sollë partizanëve fjalët më të ngrohta nga organet më të larta për sulmin e djeshëm që u kurorëzua me sukses.

Megjithëse luftimet vazhduan dhe batalioni IV edhe më vonë u ndesh me gjermanët, ky sulm u quajt sulmi i fundit.

Në raportin Nr. 35/21) komanda e batalionit për heroizëm të rrallë lavdëronte shokët Nazif Again, Kajmak Qerimin, Nevruz Bubsin, Vangjel Tikon, Ferit Rexhepin, Pandi Budën, Vasil Priftin, Feta Dinon si dhe të plagosurit Vangjel Bushin, Tajar Xhaferin, Tefik Dinen, Demir Bektashin, Sotir Cimon, Alush Metin, Nazif Ismailin.

Mbas këtij sulmi buçiste kënga:

*Në malet mbi Vishegrad
Seç lufton Brigad' e shtatë
Lufto ditë e luftë natë
Tunde moj Brigad' e shtatë...*

1) Arkivi Qendror i Ushtrisë, Fondi Brigada VII, dok Nr. 35/2, Dosja Nr. 1.

NË PRAPAVIJË TË ARMIKUT

Megjithëse Brigada VII pushonte në afërsitë e qytetit Rudo, ajo nuk e ndërpreu aktivitetin e zbulimit me shpresë se, mbas një pushimi të shkurtër, do të vazhdonte përsëri përpara.

Një njësit, i komanduar nga oficeri informativ Foto Puka dhe zëvendësi i tij Zenel Hyseni, u fut në prapavijë të armikut. Grupi i zbulimit veprroi në thellësi të formacioneve gjermane. Sa herë ju desh atyre të rrinin pa lëvizur, pa ngrënë, të strukeshin rrëzë lumit nën ujë brenda, duke mbajtur përjashta vetëm kryet.

Është për t'u vënë në dukje se edhe banorët në prapavijë të armikut kishin ikur dhe i kishin lënë fshatrat shkretë, ndërsa ata pak veta që kishin mbetur ishin nën ndikimin e armikut.

Me gjithë vështirësitë, njësitet tona vazhdonin të kryenin detyrën me nder. Ja raporti i një njësi, drejtuar shtabit nga prapavija e armikut:

«Lumi Drinos mund të kalohet në Vah në afërsitë e Holjaçit. Nga Vishegradi në Rangatica

janë përqëndruar tre regjimente gjermane, i 363-ti, i 359-ti dhe njërit nuk i dihet emri.

Çdo regiment ka nga katër batalione dhe çdo batalion nga 300-400 vetë...

Nga Rangatica në Sarajevo ka tre divizione gjermane, i 863-ti, i 999-ti dhe i 297-ti...»1)

Në këtë mënyrë partizanët tanë trima vepronin deri në afërsitë e Sarajevos dhe ju jepnin informatat të sigurta shtabeve tona. Në bazë të këtyre informatave hartoheshin planet dhe merreshin vendime.

Njësitë që përmendëm më lart po kthehej në shtab, mbasi hartoi raportin, bëri skicën dhe plotësoi detyrën e ngarkuar.

Ditët kalonin njëra pas tjetrës dhe tani qyteti i Vishegradit ishte në duart e divizionit shqiptar. Meqë këtë qytet e kishin forcat tona gjatë kthimit njësitit as që i shkoi ndër mend se gjermanët nga ana tjetër e lumit mbanin ende një kryeurë (një rajon). Ky garnizon gjermanësh vazhdonte të mbrohej në mënyrë të çrregullt, dhe në të njëjtën kohë vazhdonte të tërhiqte material luftarak.

Njësitë vazhdoi marshimin rrugës hekurudhore, gjatë bregut të lumit Drinos.

Përpara printe Foto Puka, i çili ishte shkëputur nga shokët nja njëqind metra.

Kthesat linin prapa njëra-tjetrën dhe njësitë përitur u futën midis garnizonit gjerman. Kthimi mbra-pa ose dhënja e udhëzimeve të mëtejshme ishte e pamundur, sepse njësitë ishte futur mjaft thellë.

Nr. 4.

1) Arkivi Qendror i Ushtrisë. Fondi i Brig. VII Dosja.

Fotua pa e ndalur hapin vendosi të dalë përmes gjermanëve nga ana e mbrapme e garnizonit në drejtim të jugut. Ai e çmoi drejt situatën, veproi shpejt, mirë dhe me guxim.

Në kodrën e pyllëzuar ishin ndërtuar llogoret e gjermanëve, më në thellësi ishin një palë llogore të tjera ndërsa në veri kishte një portë të pa fortifikuar. Në jug, përveç një porte tjetër që ndodhej kishte dhe qendra zjarri të kryqëzuara, ndërsa më tej vazhdonte thurja e këtij garnizoni me sipërfaqe të mëdha me tela gjembash. Në rrëzë të kodrave jo shumë larg stacionit hekurudhor kishte fortifikata, disa barraka, strehime dhe depo gjysëm të tunelizuara. Nga perëndimi ishte lumi Drinos.

Në kohën që Fotua ecte përpara, një gjerman e pyet: «Çetnik»?

Fotua u përgjeggj: «Çetnik», «Çetnik» dhe, mbase maskoi yllin e kuq, eci përpara.

Prapa vinin shokët e tjerë të komanduar nga Zenel Hyseni, një partizan i vogël, informator i batalionit, një djalë i shëndoshë me trup mesatar dhe mjaft i shkathët.

Një gjerman ju afrova «grupit të çetnikëve» dhe u kërkoi të ndizte cigaren. Partizani me gjakftohësi ja ndezi cigaren, por gjermani i sheh një shoku yllin e kuq dhe bërtiti me të madhe: «Partizan». Aty për aty Zeneli i dha përgjegjen, duke e rrëzuar për tokë me tri të shtëna revolveri.

— Përpara drejt Fotos! — komandoi ai skuadrën. Partizanët u bindën dhe ashtu vepruan. Llukë Prifti, komandanti i skuadrës ktheu kokën dhe e pa Zenelin për të fundit herë të vrenjtur, me një shikim jo të zakonshëm, me automatik në dorë, me

revolver zbërthyer, i gatshëm për një luftim të vërtetë.

Zenel Hyseni ishte bir i një fshatari të varfër nga Sevrani i Skraparit. Sa kishte vuajtur familja e tij për bukën, për tokën, për jetën! Ai dhe vëllezërit e tij që tani ishin hedhur të gjithë në luftë, ishin endur për vite të tëra në dyert e botës për të siguruar bukën. Sa herë e kishin dëgjuar ata të jatën, kur u tregonte për luftën e gjyshit të tyre, për trimëritë e tij, kur u tregonte për të parët tanë që kishin luftuar kundër grekëve, kundër turqve dhe kundër të gjithë atyre që donin të pushtonin vendin tonë. Ai u kishte thënë se po të ngrihen të gjithë fukarenjtë ata i mundin agallarët, prandaj dhe tre djemtë që kishte ai i kishte partizanë.

Fotua, mbasi vrau rojen e portës së mbrapme. doli nga rrethimi i ndjekur nga shokët e tij. Vetëm Zeneli qëndroi i fundit dhe vazhdoi të qëllonte me automatik kundër gjermanëve, duke u munduar të tërhiqte vëmendjen e tyre dhe t'u jepte mundësi shokëve të dilnin përtej garnizonit armik. përtej telave. Gjermanë të tjerë dualën nga strehimet e tyre të nëndheshme dhe zunë portën e mbrapme. Ata u vërsulën si bisha të tërbuara kundër Zenelit, i cili me automatikun e tij shtriu për tokë shumë prej tyre, përdori dhe rezervën e bombave, por edhe vetë mori një plagë dhe ashtu i gjakosur rrëshqiti drejt anës së lumit me shpresë se do të gjente ndonjë shteg për të dalë nga rrethimi.

Thirri dy-tri herë: «O Llukë, o Llukë» për t'u siguruar në se shokët ishin larguar. Por shokët e dëgjuan zërin e tij pak si të mbytur dhe ju përgjegjën, por më kot. Të shtëna të tjera u dëgjuan

në anën e lumit dhe automatiku i Zenelit nuk po dëgjohej më. Përpyekjet e grupit për të tërhequr Zenelin dështuan.

Gjermanët filluan ta sulmonin dhe ta ndiqnin njësitin, por partizanët u futën thellë në pyll dhe gjermanëve nuk ua mbante më të ecnin përpara.

Zenel Hysen Nurka dha jetën me vetëdije të plotë. Ai rrezikoi veten, por shpëtoi shokët.

Kur njësiti arriti në shtab dhe u tregoi partizanëve mbi sa kishte ndodhur, të gjithëve u erdhi keq për trimin e rrallë, i cili kërkonte të ecte gjithmonë përpara, drejt Berlinit, drejt fitores.

Një kompani e tërë shkoi në vendin e ngjarjes. Gjermanët ishin larguar dhe syri nuk të shihte gjë tjetër përveç disa barraka, strehime, disa depo dhe pak predha artilerie. Ata kërkonin të gjenin trupin e Zenelit, por nuk e gjetën. Zeneli nuk dukej më, valët e Drinosit e kishin përpirë.

Njësitin e udhëhoqi me trimëri të rrallë shoku Foto Puka, informator i divizionit. Ai gjatë gjithë luftimeve, qysh nga qyteti i Lushnjës dhe deri në Vishegrad u tregua i denjë për titullin e lartë të komunistit. Ai shumë herë ishte futur midis armikut, kishte marrë plagë, por gjithmonë kishte dalë fitimtar. Nga mundimet, të ftohtit dhe plagët ai nga lufta doli i sëmurë, prandaj nuk jetoj gjatë.

NË QYTETIN RUDO

Qyteti kishte filluar të rimëkëmbej. Rrugët ishin rregulluar dhe tani punëtorët punonin me shpejtësi për të ngritur urën në afërsi të qytetit që gjermanët e kishin hedhur në erë. Qyteti Rudo është një qytet i vogël dhe njëkohësisht edhe një nyje e rëndësishme. Prej këtij qyteti mund të lidhesh me drejtimet Vishegrad-Sarajevo, Dobrun-Uzhice, Priepole-Kosovë ose Plevle-Mali i Zi.

Në zonën ku vepronte Brigada VII, në afërsi të qyteteve Rudo-Vishegrad, qëndrimi i një pjese të popullsisë nuk ishte i mirë. Ndryshe nga Mali i Zi, këtu kishte njerëz nën ndikimin e armikut, prandaj partizanët patën shumë telashe.

Forcat tona mundoheshin në çdo mënyrë të përqëndroheshin sa më afër tyre për t'i sqaruar dhe për t'i bashkuar edhe ata me vëllezërit e tyre për çështjen e përbashkët, për vëllazërimin e popujve. Brigada VII, në bashkëpunim me shokët jugosllavë, vepronte në zona të ndryshme për të asgjësuar elementët armiq. Kështu vepruan batalioni II dhe V në katundin Zllatari, të cilët kapën 15 çetnikë.



Partizane të Brigadës VII Sulmuese.

Vështirësitë po shtoheshin, bora vazhdonte të binte, ushqimi ishte i paktë dhe i keq, madje pati raste që partizanët nuk hanin fare ose ndanin nga një kokër patate. Vetëm për të sëmurët me vështirësi siguronin pak miell misri nëpërmjet komandës së vendit, gatuanin kaçamake me ujë e kripë.

Në Brigadën VII kishte mjaft shoqe. Disa prej tyre ishin kuadro, anëtare të PKSH që luftonin jo më pak se shokët e tyre. Ato ndanin me shokët e tyre të mirën e të ligën, dalloheshin jo vetëm për trimëri, por edhe për punë agjitative, dalloheshin si infermiere, si ekonomate dhe si amvisa të mira.

Kështu mund të përmendim Firdes Beqarin (dëshmore), Shanisha Demin, Ylvie Shehun, Ismiha Likën, Nepi Sotën, Vala Gjeçin, Hatixhe Menishën, Sava Zogasin etj.

Tom Karadaku ishte përsëri shumë sëmure. Ai si të thuash e kuptonte se do të vdiste dhe nuk i vinte mirë që nuk do të shikonte frytet e sakrificave të tij, nuk do të shikonte në realitet ëndërrat e tij. Në një kohë kur në Shqipëri kishte filluar një jetë e re ai po kalonte çastet e fundit të jetës larg atdheut të tij së bashku me trimin e plagosur rëndë Selim Xhelon.

Nepi Sota i çonte vazhdimisht atyre ndonjë patate të pjekur. Shoqet përkujdeseshin për ta.

«Ti do të rrosh, — i thosh Tomi Selimit, — se je i ri dhe do ta mposhtësh plagën, ndërsa unë jam dobësuar mjaft. Me siguri kam tifon. Selimi e shikonte dhe nuk fliste, ai kërkonte ujë dhe shoqet i lagnin vetëm buzët. Tomi nuk hante më ushqim, ai jua jepte partizanëve ose njerëzve që e rrethonin, por asnjëri s'e prekte ushqimin e tij megjithëse partizanët ishin të uritur dhe vuanin për ushqim, për arsye se komandanti i vendit të qytetit nuk interesohet për furnizimin e partizanëve. Ushqimi i Tomit dhe i Selimit rrinte aty për ditë të tëra.

Një mbasadreke Selimi vdiq dhe në agimin e ditës tjetër vdiq edhe Tomi. Në varrimin e tyre muarën pjesë të gjithë partizanët, komandantët dhe komisarët që ndodheshin në periferi.

Populli shqiptar dërgoi bijtë e tij më të mirë për të ndihmuar popullin jugosllav në luftën e përbashkët kundër fashizmit dhe populli jugosllav i mbajti, i strehoi dhe i furnizoi si bijtë e tij par-

tizanët shqiptarë. Por pati disa vetë ose komanda të veçanta që nuk i çonin çështjet deri në fund ose pengonin forcimin e miqësisë midis dy popujve duke vënë shpesh në dyshim qëndrimin e tyre. Kjo u vu re sidomos te komandanti i Brigadës V sanxhake dhe te komandanti i vendit të qytetit Rudo, prandaj komanda e brigadës sonë u detyrua t'i drejtonte komandës së divizionit disa raporte e shkresa, në të cilat i ankohet për mosvazhdimin e mësymjes më datën 5.2.1945 shkresën Nr.134/13, për përkrahjen e disa çetnikëve, për sjellje të keqe me popullin, sidomos me pleqtë dhe gratë, për mosfurnizimin me ushqime të partizanëve e të tjera. Komanda e brigadës me shkresën Nr.152 datë 26.2.1945 i raportonte komandës superiore se komanda e vendit të qytetit Rudo është duke rënë në pozitë të asaj pjese të popullsisë që është reaktionare dhe mundohet të çajë vëllazërimin midis dy popujve të brumosur me gjak dëshmorësh, madje në shkresën Nr.34/47 arrinte deri atje sa të dyshonte se mos në komandën e vendit të qytetit Rudo të kishte elementë armiq¹⁾.

Megjithatë asnjëherë nuk dyshohej se këto gjëra mund të bëheshin me qëllim. Komanda e partia në brigadë mendonin se këto ishin gabime të pjesshme të personave dhe komandave të veçanta, të reparteve partizane jugosllave.

Më datën 22.2.1945 në sheshin e qytetit Rudo u bë manifestimi me rastin e festës së Ushtrisë së Kuqe. Aty partizanët shqiptarë dhe jugosllavë kër-

1) Arkivi Qendror i Ushtrisë. Fondi Brigada VII. Dosja Nr. 3.

cenin bashku si vëllezër dhe këndonin këngë të njohura partizane shqiptare dhe jugosllave.

Më tej një grup partizanësh shqiptarë e jugosllavë kishin bërë një rreth, kishin hedhur duart në qafë shoku-shokut dhe këndonin këngën:

*O Stalin o vojska gllava
Shto ti kazhesh imash pravo¹⁾*

* * *

Armiku vazhdonte të tërhiqej. Ushtria e Kuqe marshonte drejt Berlinit. Më datën 23 shkurt të vitit 1945 në qytetin Rudo u mbajt një meeting ku folën përfaqësues shqiptarë e jugosllavë. Mbas meetingut u bë një parakalim i rastit.

Në mbrëmjen e organizuar në qytetin Rudo foli komisari i Brigadës VII sulmuese, shoku Qazim Kapisyzi. Ai foli për Ushtrinë e Kuqe, për sukseset e saj dhe për Stalinin e madh. Fjalimin e tij të pranishmit e ndërprejnë shumë herë me duartrokitje të parreshtura. Shoku Qazim foli mbi luftën e popullit dhe të ushtrisë sonë në tokat jugosllave. Ai përmendi fakte konkrete nga lufta e divizioneve tona dhe tha se gjaku i dëshmorëve tanë që ranë në luftën e përbashkët nuk do të shkojë kot, por do të jetë një kontribut i madh për vëllazërimin e popujve, për komunizmin.

«Nuk do të ketë forcë, — tha ai, — që të prishë miqësinë tonë — në këtë kohë komisari ktheu

1) O Stalin, o udhëheqës ushtarak ç'thua ti është e drejtë.

kokën nga komandanti i vendit — që të mohojë gjakun, mundin dhe punën tonë për çlirimin e vëllezërve tanë».

Komandanti i qytetit Rudo uli kokën dhe diç po shkruante në blok. Nga mbarimi i fjalimit të gjithë u ngritën në këmbë duke brohoritur.

Në fund e mori fjalën komandanti i qytetit Rudo, i cili përforcoi disa fakte që përmendi komisar i brigadës. Aty nga fundi ai foli për miqësinë midis vendeve tona.

Aty u hodh parulla «Vëllazërim, bashkim», sipas së cilës në thelb fshihej synimi i maskuar shovinist i titistëve për të futur në dorë vendin tonë. Ky qëllim kishte nxjerrë kokë që në verën e vitit 1943, kur vetë Vukmanoviç Tempua kërkoi të formonte shtabin e përbashkët ballkanik me Titon në krye!).

Në fund u dha një shfaqje teatrale.

1) Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë, f. 178.

NË KOSOVË

Mbas qindra kilometra marshimi të vështirë në të ftohtë dhe pa ngrënë duke kaluar nëpër katunde të infektuara nga tifua arritëm në Kosovë.

Më datën 12.3.1945 brigada jonë kaloi përpara popullit të qytetit të Mitrovicës dhe në mbrëmjen e asaj dite u vendos në qytetin Podojevë. Batalionet u shpërndanë nëpër katundet përreth, batalioni II u caktua të pushonte në katundin Dubnicë.

Këtu ata u pritën ngrohtë nga populli kosovar që ishte brumosur me një urrejtje të madhe ndaj sërbbomëdhenjve.

Në të gjithë territorin e Kosovës dhe në periferi të saj qarkullonin banda tradhëtarësh, të cilat shpeshherë lëviznin nga Serbia në Maqedoni dhe anasjelltas. Mercenarët e krajlit, të cilët tanixhëtin më shumë prej anglezëve se sa prej gjermanëve, bënë përsëri presion të vazhdueshëm për të marrë pushtetin e humbur. Ata vazhdonin të hidhnin si me anë të ajrit ashtu dhe nga toka banda të shumta.

Përkrah këtyre bandave vepronin dhe disa mercenarë të Xhafer Devës. Ky mik i gjermanëve

në bashkëpunim me ambasadorin «Nojbahër» ishin përpjekur që në Shqipëri, në Kosovë e në Mal të Zi të krijonin një qeveri të përbashkët fashiste. Fatin e gjermanëve e pësoi dhe Xhafer Deva me mercenarët e tij. Disa filluan të dorëzoheshin, disa endeshin nëpër male.

Nën pretekstin e shkatërrimit të këtyre bandave shovinistët serbomëdhenj pa bërë dallime, masakronin popullin e pafajshëm dhe e nxinin edhe më tej frymën nacional-shoviniste. Ata vranë me qindra të pafajshëm, ndërroan disa herë organet e pushtetit dhe çarmatosën shumë vullnetarë kosovarë.

Më datën 8.4.1945 u dorëzuan 18 të arratisur, të cilët deklaruan: «U arratisëm se komanda na çarmatosi dhe donin të na çonin në batalionet e punës!».

Për të gjitha këto arsye ishte krijuar një hendek i madh midis popullit kosovar dhe reparteve të ushtrisë jugosllave. Fshatarët në bisedat me partizanët shqiptarë shpreheshin kundër tyre. Ata arrinin deri atje sa të vinin në dyshim pushtetin dhe tregonin ndodhi të papëlqyeshme.

Më datën 22.3.1945 në rrethimin që ju bë katundit Ramnisht u shti në dorë Aqif Barami, nëntoger i regjimentit kosovar me katër shokë të tjerë dhe materiale të ndryshme, të cilët, mbasi u çarmatosën, u dërguan në shtab.

Batalioni II ashtu si gjithë të tjerët kalonte sa në një pritë në tjetrën. Një natë aeroplanët hodhën mjaft diversantë në pyllin e Lieva-Rëkës.

1) Arkivi Qendror i Ushtrisë, Fondi Divizioni VI. Dosja Nr. 1.

Partizanët shqiptarë menjëherë rrethuan këtë vend kodrinor dhe të pyllëzuar.

Një kompani mbajti lartësinë lindore dhe, duke u afruar, ngushtonte rrethimin e banditëve. Aty ku pylli ishte më i dendur dhe më kodrinor midis dy luginave të vogla filloi një luftim i rreptë. Ata qëlluan të parët dhe vranë një shok shqiptar. Partizanët u shtrinë dhe filluan të zvarriten nëpër pozicione më të përshtatshme. Lufta vazhdoi për orë të tëra. Banditët rezistuan gjatë gjithë ditës dhe prisnin që të errej, ndërsa partizanët kërkonin shfarosjen e tyre para se sa të errej. Kompania II u hodh në sulm drejt tyre, ndërsa kompania I i priti në pozicionet që kishin zënë.

Kur banditët e panë ngushtë, filluan të shpërndaheshin në disa drejtime për të çarë rrethimin. Filloi një përleshje trup me trup. Një bandit ju hodh në grykë një partizani dhe u kap fyta me të. Partizani e kapi fort banditin dhe, ndërsa i kërkonte ndihmë një shokut tij, nuk e lëshonte atë. Shoku u afrua në ndihmë të partizanit dhe, duke drejtuar tytën e pushkës nga banditi, i thoshte shokut të tij ta lëshonte, në mënyrë që ta qëllonte, por banditi i stërvitur mirë manevronte për të mos u goditur. Së fundi partizani i detyruar nga kërkesa e shokut të tij qëlloi banditin mes për mes, por plumbi plagosi në mesin e dorës edhe shokun e tij. Në këtë mënyrë u vra një nga banditët më të rrezikshëm.

Aty u vranë shumë banditë, midis tyre edhe komandanti i tyre Sllabodan Maderkoviç. Më datën 12.4.1945 u zunë nëntë banditë të tjerë dhe ndjekja e tyre vazhdoi përsëri.

Përveç punës për asgjësimin e bandave ko-

mandantët dhe komisarët tanë mbanin konferenca në popull, i tregonin popullit kosovar luftën dhe fitoret e popullit tonë, i tregonin perspektivat për të ardhmen. Ata dëgjonin me vëmendje dhe shpesh shpërthenin një sëri pyetjesh që shumë herë shokët tanë për t'ju përgjegjur viheshin në pozita të vështira. Kështu, psh, ata pyesnin:

— Nga kush do të qeverisemi ne në të ardhmen?

— Ku do ta kryejmë ushtrinë?

— Mësuesit a do të jenë shqiptarë?

Mbas gjithë asaj pune të vazhdueshme çdo ditë filluan të vinin vullnetarë dhe të rreshtoheshin në radhët tona. Kështu, p.sh., në datën 1.4.1945 u paraqitën 40 vullnetarë në datën 2 — 21 vullnetarë; në datën 7 — 15 vullnetarë, në datën 9 — 25 vullnetarë, në datën 10 — 35 vullnetarë e kështu me radhë¹). Kjo punë vazhdonte dhe në brigadat e tjera. Në ushtrinë tonë u rreshtuan me mijëra vullnetarë.

Jo vetëm në popullin e Kosovës, por edhe në popujt e kombësive të tjera ushtria shqiptare fitoi simpati dhe autoritet të madh. Partizanët punonin plot vrull pa i dalluar në kosovarë e maqedonas, në sërbë e malazezë.

Një ditë shkuan në qytetin e Vuçiternës. Atje u bë një meeting për njohjen e qeverisë shqiptare nga Konferenca e San-Franciskos dhe ju drejtua një telegram shumë i gjatë misionit aleat²), në lidhje me padrejtësitë që i bëheshin popullit tonë.

1) Arkivi Qendror i Ushtrisë. Fondi Divizionit VI. Dosja Nr. 1.

2) Arkivi Qendror i Ushtrisë. Fondi Brigada VII. Dosja Nr. 4.

Duke kaluar gjatë rrugës kryesore, me partizanët u bashkuan dhe turma nga qytetarë të çdo kombësie, të cilët brohorisnin: «Duam njohjen e qeverisë shqiptare!», «Nuk durojmë padrejtësitë!», «Rroftë shoku Enver Hoxha!», «Nuk pranojmë të shkelet gjaku i dëshmorëve tanë!» dhe shumë parulla të tjera. Brohoritja dhe entuziazmi i madh që u vu re në këtë demonstrim të bindte edhe më shumë për dashurinë që kishte ky popull për partinë tonë, për ushtrinë tonë, për shokun Enver Hoxha.

Partizanët u kthyen përsëri në rrethin e Podojevës dhe vazhduan punën sipas planit për të plotësuar detyrat që shtronte partia.

VULLNETARI KOSOVAR

Partizanët e batalionit të dytë të Brigadës VII vazhdonin të qarkullonin në të gjithë rrethin e Podujevës, por qendrën e kishin në katundin Dubnicë. Midis vullnetarëve të tjerë kosovarë këtu erdhi vullnetar edhe Ibrahim. Ibrahim ishte një djalë afër 30 vjeç, i bëshëm, i dashur me shokët, trim dhe me sedër. Shpesh partizanët bisedonin me Ibrahimin për luftën, për të ardhmen, për vëllazërimin e popujve, por Ibrahim nuk besonte. Duke qenë i shtypur dhe gjithmonë nën thundrën e të tjerëve ai nuk bënte dallim midis pushtetit të vjetër dhe pushtetit të ri që sapo ishte ngritur.

«Jo, — thoshte ai — unë nuk shoh ndonjë dallim midis tyre. Më përpara na kanë vrarë, por edhe tani na vrasin për shkaqe të ndryshme. Ja, — tha ai dhe tregoi me dorë një pyll të madh në verilindje të Vuçiternës, — atje ata pushkatuan 300 nga tanët» — dhe kështu vazhdonte të tregonte ndodhi të tjera të këtij lloji.

Një ditë partizanët në bashkëveprim me forcat jugosllave rrethuan në afërsi të Gjilanit një bandë

tradhëtarësh. Për çudi, banda doli nga rrethimi nga ana e forcave jugosllave. Ibrahimimi nuk nguroi përsëri të shfrynte kundër disa udhëheqësve të forcave jugosllave.

— Jo, — i tha komandanti i kompanisë — nuk është ashtu! Edhe ne mund të na dilnin nga rrethimi. Ja, në Lieva-Reka edhe ne na shpëtuan disa prej tyre.

— Po, — tha Ibrahimimi, — shpëtuan, por komandanti i tyre dhe shumë të tjerë u vranë, unë isha në varrimin e tyre.

Komisari i shpjegonte vazhdimisht Ibrahimimit se mund të bëheshin gabime nga persona dhe komanda të veçata por vija marksiste-leniniste që ndiqte partia jonë, pavarësisht nga pengesat, do të triumfonte.

Partizanët kishin dëshirë të bisedonin me Ibrahimimin, bënë shaka me të, madje dhe shoqet e ngacmonin sepse Ibrahimimi shpeshherë e vinte me dyshim luftën e shoqeve tona dhe të rinjve tanë.

Një ditë komisarit i hoqi mënjanë Ibrahimimin. Biseda vazhdoi më tepër se dy orë dhe që prej asaj dite Ibrahimimi ishte më i gëzuar, fjalët e komisarit e kishin ngrohur.

Më 15.4.1945, me rastin e hapjes së Kongresit II, shumë të rinj shkuan në Vuçiternë, ku ishte komanda e divizionit. Ibrahimimi, megjithëse ishte i madh nga mosha, partizanët e muarën me vete, mbasi përveç mbledhjes do të bëheshin edhe disa gara sportive midis brigadave.

Ja, atje tej dukej një tribunë e zbukuruar me gjethe të freskëta e me flamuj, dhe më poshtë në një shesh ishin vizatuar disa vija të bardha, ku do të bëheshin garat sportive. Më tej dukeshin

grumbuj armësh, me të cilat partizanët do të zhvillonin mbërthimin dhe zbërthimin e tyre.

Ibrahimi shoqërohej me një partizan. Ata u afruan pranë vijave të bardha dhe prisnin të fillojnë garat. Nuk vonoi dhe garat filluan.

Në start për vrapimin 100 m. u radhit edhe një komandant që ishte pothuajse i një moshe me Ibrahimin. Ai i dorëzoi një partizani automatikun, gjerdanin e fishekëve e të bombave, revolverin, thikën dhe hoqi këpucët. Ky ishte komandanti i kompanisë I.

— A e njihni këtë? — pyeti Ibrahimi shokun e tij.

— E njoh, — u përgjegj ai, — ai është një partizan i vjetër.

— Po a mundet të vrapojë ky më shumë se këta djemtë e rinj?

— Eh, Ibrahim, nuk e di se çfarë vendi do të zejë, por di se ai është një nga partizanët që ka bërë qindra mijëra kilometra në këmbë, i ka rënë më këmbë disa herë që nga Shqipëria e Jugut e deri në Alpet e Veriut, deri në Vishegrad dhe prej andej ka ardhur këtu. Është aq i shpejtë sa ti nuk e merr me mend!

Ibrahimi nuk i ndau sytë nga partizani, i cili me të vërtetë zuri vendin e parë.

Prej andej Ibrahimi krah për krah me partizanin shkuan atje ku bëhej mbërthimi dhe zbërthimi i armëve. Ibrahimi mori pjesë në mbërthim-zbërthimin e mitralozit dhe zuri vendin e dytë. Atij i erdhi çudi se në garat mbërthim-zbërthim i pushkës me sy të mbyllura, merrte pjesë dhe një shoqe. Ajo ishte Nepi Sota nga Fieri, një vajzë shumë e shkathët.

Dikur Ibrahimimi ishte shprehur kundër shoqeve. Atij nuk i mbushej mendja se edhe ato mund të luftonin njëlloj si burrat. Por tani ai ja kishte ngulur sytë Nepit dhe po e shikonte se me sa shkathësi ajo e mbërthente dhe e zbërthente pushkën.

Me rastin e mbylljes së garave, përgjegjësja e rinisë së Brigadës VII, shoqja Ylvie Shehu, mbajti një fjalim.

Përsëri Ibrahimimi u habit se si në këtë meeting kaq serioz fliste një vajzë e re.

Ai e kishte përqëndruar vëmendjen nga tribuna.

Shoqja Ylvie Shehu foli gjatë për punën e rinisë, për aktet heroike të rinisë sonë, ajo përmendi luftimet më kryesore të Brigadës VII dhe së fundi tha se nga shumë dëshmorë që i dha luftës kjo brigadë 70 për qind të tyre ishin të rinj komunistë, ishin ata të rinj që nuk kursyen as jetën dhe as gjakun e tyre në luftën e madhe kundër armikut të përbashkët, për çlirim e atdheut dhe për të ndihmuar popujt e tjerë.

Ibrahimimi uli kokën dhe që prej asaj dite filloi të mendonte më ndryshe edhe për gratë. Më shumë ju forcua mendimi kur partizanët u kthyen në Podujevë dhe shkuan përsëri për rrethimin e bandave.

Të dhënat ishin të sigurta. Rrethimi po kryhej me mjeshtëri. Ibrahimimi me katër shokë të tjerë, mbasi lanë përroi e madh, u kthyen majtas në drejtim të një përroi të vogël dhe, mbasi kaluan disa pengesa prej gurësh të përzierë me ujë që rridhte, dualën në një luginë. Në pesëshen e tyre bënte pjesë dhe një shoqe e quajtur Ismiha Lika. Ajo ishte me të vërtetë trime!

Ibrahimiti nuk i vinte mirë që shpeshherë

Ismihaja dilte përpara tij dhe mbante vesh me mjeshtëri, në gatishmëri për t'u hedhur e para drejt banditëve.

— Mbërritëm, — tha komandanti. — Të gjithë zini vendet dhe mos bëni asnjë lëvizje pa urdhër! Kemi për detyrë që të mos lejojmë banditët të kalojnë as nga përroi dhe as nga pllaja përballë.

Të gjithë u vendosën ndër pozicione. Ismihaja ndejti pas një guri me automatik, në gatishmëri për të hapur zjarr duke ruajtur kryesisht përroin. Ibrahimimi u vendos pranë një lisi në ruajtje të pllajës gjysmë të pyllëzuar.

Filloi të zbardhte dita. Së largu dalloheshin disa zjarre. Banditët e kishin diktuar me kohë rrethimin, prandaj e filluan të parët sulmin për të dalë nga rrethimi. Ata ishin shumë. Një pjesë e tyre u sul drejt përroit, ku Ismihaja i priti me breshëri të gjata automatiku dhe vrau një prej tyre. Kur panë banditët se përroi ishte zënë, filluan të ikin gjatë pllajës. Ibrahimimi i shtrirë barkas po qëllonte në drejtim të tyre. Kur Ismihaja pa se ata e ndryshuan drejtimin, vrapoi në drejtim të Ibrahimit drejt lisit ku ishte shtrirë dhe qëllonte ai, duke qëlluar nga pozicioni në këmbë.

Ibrahimimi ngriti kryet dhe e pa me habi këtë vajzë trime. Pastaj përsëri vazhdoi të qëllonte kundër banditëve, të cilët u larguan duke lënë edhe dy të vrarë. Shokët e tjerë kishin zënë 8 banditë të gjallë.

Që prej asaj dite Ibrahimimi u bind edhe më shumë se vajzat ishin me të vërtetë shoqe të denja për luftë e për punë.

KOLË MYZEQARI

Partizanët shqiptarë edhe në Kosovë vazhdonin të luftonin kundër vështirësive, kundër lodhjes, të ftohtit dhe sëmundjeve të ndryshme. Megjithëse për të ngrënë ishte më lehtë, për arsye se vendasit i furnizonin me ushqim, prapëseprapë kishte raste që ata mbeteshin pa ngrënë.

Me gjithë inxheksionet kundër tifos, përsëri kjo sëmundje e tmerrshme vazhdonte të bënte dëme të mëdha.

Ishte dhënë urdhër që të sëmurët nga tifua të izoloheshin dhe të mos vizitoheshin nga partizanët e tjerë. Po a mund t'i ndaloje atëhere shokët e tyre të takoheshin me ta? A mund t'i ndaloje vetë komandantët dhe komisarët të vizitonin partizanët? Solidariteti partizan ishte aq i madh sa që ata ishin gati të ndanin edhe sëmundjen midis tyre.

Kjo sëmundje e rrezikshme atëhere kapte më tepër ata shokë që ishin më të dobët fizikisht, që lodheshin më shpejt dhe ata që kishin marrë plagë gjatë luftës. I tillë ishte Kolë Myzeqari, zëven-



Dëshmori Kolë Myzeqari

dëskomisari i ri i Brigadës VII. Ai punonte aq shumë, sa që rrallë i takonte të pushonte 3-4 orë në natë.

— Jo, — i thoshte Koli komisarit të brigadës, shokut Qazim Kapisyzi, — do të shkoj unë atje!..

Komisari shpeshherë nuk e lejonte Kolin të shkante kudo.

Ata të dy së bashku kishin shumë punë: duhej të mbanin konferenca me partizanët, në popull, të organizonin meetingje, të organizonin mbledhje me komisarët e batalioneve e të kompanive, të merrnin pjesë në mbledhjet e celulave të kompanive e të batalioneve, në mbledhjet e rinisë, të pregatisnin ndonjë referat për ta mbajtur në ndonjë meeting, të merrnin pjesë në mbledhjet e agjitorëve, të organizonin ndonjë shfaqje teatrale dhe më kryesorja të bënin plane të ndryshme për zhdukjen e bandave dhe madje të merrnin pjesë në asgjësimin e tyre, pa llogaritur raportet dhe statistikat që kërkonte shtabi i divizionit dhe Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare.

Për të gjitha këto punë përgjigjeshin komisarit dhe zëvendëskomisari i brigadës.

Me gjithë punën e madhe që kishin Koli gjente kohë të vizitonte të sëmurët, si ata që kishin sëmundje ose plagë të ndryshme ashtu edhe ata me tifo. Ai bisedonte me ta, u qante hallin, interesohej për ushqimin e tyre dhe u jepte kurajo. Kushdo që e kishte njohur këtë punëtor partie, këtë komisar të Luftës nacionalçlirimtare, dallonte te ai virtytet më të mira të komunistit: shok i thjeshtë ndër të thjeshtit, punëtor ndër punëtorët, trim ndër trimat.

E ku s'e gjeje Kolë Myzeqarin, këtë bir të klases punëtore!

Në fillim ai ishte partizan në Qarkun e Beratit dhe më vonë në Brigadën VII Sulmuese.

Gjatë Operacionit të Qershorit në luftën e Qafë Shkozës dhe të Paraspurarit, Brigada VII korri suksese të rëndësishme. Për një javë ajo e ndaloi armikun në vend dhe vrau shumë gjermanë, por edhe nga ana e partizanëve pati mjaft të vrarë e të plagosur.

Kompania ku bënte pjesë Koli ishte në rrezik. Komandanti i kompanisë, Sabri Sevrani, i cili shkonte gjithmonë në vijën e parë u plagos rëndë. Këtë fat pësoi edhe mitralieri Ferit Leshnja.

Në këto çaste shumë të vështira radhët e kompanisë filluan të lëkunden. Duhej patjetër të mbahej lart morali i partizanëve. Në krye doli komisar, i cili luftoi dhe i detyroi gjermanët të ndalnin sulmin. Por edhe komisar u plagos. Plumbi i përshkoi shpatullën dhe i doli pranë gjoksit, por komisar nuk e bëri veten, ai nuk u tregoi shokëve, sepse ai e kuptonte mirë se çfarë do të ndodhte po të largohej edhe ai. Me vështirësi u mbajt derisa kaloi rreziku pastaj pa ndjenja u shtri për tokë.

Partizanët e muarën komisarin e tyre dhe e shoqëruan për në spital. Shpejt ai u bë më mirë dhe u kthye te shokët e tij që e prisnin me padurim.

Në luftën e Mirditës ai përsëri me kompaninë e tij çau përmes gjermanëve gjatë pyllit përpara katundit të Gëziçit dhe u dha atyre një mësim të mirë.

Disa herë në Mal të Zi e në Vishegrad ai nuk u nda nga vija e parë. Tani përsëri, përveç punës së madhe që kishte si organizator, ai kërkonte të shkonte në radhët e partizanëve për të marrë pjesë

në asgjësimin e bandave diversante, por nga lodhja e tepërt, nga plaga që kishte marrë dhe nga që ishte dobësuar shumë ai u sëmur rëndë.

Për ditë të ai shkonin për ta parë komisar i brigadës, komandantë e komisarë si dhe partizanë të thjeshtë.

Për Kolin kishin dashuri jo vetëm shokët e tij, por edhe ata kosovarë e jugosllavë që e njihnin. Ai njihej me të gjithë autoritetet e vendit dhe nga të gjithë gëzonte respekt. Sa herë që ishte i pranishëm në mbledhje të ndryshme, në festa, në mbërmje e kudo ai ruante me vigjilencë vijën e partisë dhe ishte i gatshëm për çdo sakrificë.

Sa vinte shëndeti i Kolit po keqësohej më tepër dhe më datën 27.3.1945 ai u nda përgjithmonë nga shokët e tij.

Vdekja e zëvendëskomisarit të ri të brigadës preku thellë jo vetëm shokët e tij, por edhe vullnetarët kosovarë, popullin kosovar e jugosllav që e kishte njohur.

Prandaj në varrimin e Kolit mori pjesë pothuajse e gjithë Brigada VII, fshatarë dhe qytetarë të rrethit të Podovejës, autoritete ushtarake e civile, përfaqësues të komandës së divizionit. Mbi arkivolin e tij u mbajtën fjalime dhe u thanë fjalët më të mira për këtë shok që nuk kurseu asnjëherë energjitë e tia, jetën e tij për çështjen e çlirimit. Përfaqësuesi jugosllav shprehu dashurinë e pakufishme për ushtrinë tonë, për luftën dhe sakrificat e partizanëve shqiptarë, për ndihmën që dhanë dy divizionet tona për çlirimin e qyteteve në Malin e Zi, në Kosovë e në Bosnjë.



Varrimi i dëshmorit Kolë Myzeqari.

Në të dyja anët ishin meshtuar për nder armë dy toga; në njërën anë një togë shqiptare dhe në tjetrën anë një togë jugosllave. Mbasi ju dha lamtumira e fundit nga shokët e tij, trupi i Kolit u varros në afërsitë e qytetit të Podovejës. Ai u radhit në radhët e dëshmorëve tanë të rënë përtej kufirit.

TAKIM I PËRZEMËRT

Mbasi kaluan qytetet Preshev-Shkup-Tetovë, partizanët shqiptarë mbërritën në qytetin e Gostivarit.

Disa shokëve u takoi të pushonin në kazernat që ndodheshin buzë lumit, në jug të qytetit. Të tjerë u vendosën në disa shtëpi të mëdha që ishin të pabanueshme. Kishte dhe nga ata që pushuan ndër baza në qendrën e banuar Banica, e cila quhej si lagje e këtij qyteti.

Patrullimet në reparte larg qytetit ishin të rralla. Ishte gjysma e dytë e vitit 1945 dhe çdo gjë po vinte drejt stabilizimit. Përdorimi i reparteve të mëdha kundër bandave dalëngadalë po bëhej i panevojshëm. Megjithatë partizanët rrinin në gati-shmëri.

Ishte ditë e shtunë. Partizanët po lanin teshat buzë lumit dhe anës kanalit vaditës që vazhdonte në pllajën jugore të qytetit. Në të dyja anët e lumit kishte shumë gjelbërim, kopshtet e shumta me mollë dhe me fruta të tjera i jepnin këtij vendi një bukuri të rrallë.

Pa mbaruar mirë së lari teshat, u dëgjuan thirrje «alarm». Nga bregu përballë dhe nga gryka më poshtë vinin tingujt e borisë të xha Sinanit, i cili megjithëse ishte në detyrën e komandantit të kompanisë, kryente dhe detyrën e borizanit.

Partizanët i mblodhën shpejt teshat dhe vrapuan drejt vendit të caktuar.

Për dhjetë minuta i gjithë reparti u rreshtua dhe ishte gati për të marrë detyrën.

Mbas dy ditëve brigadën tonë e vizitoi shoku Mehmet Shehu. Për pritjen e tij e gjithë brigada ishte rreshtuar në fushë. Kur udhëheqësi ynë u afrua buçitën urra të forta për PKS, për shokun Enver Hoxha, për shokun Mehmet Shehu. Shumë partizanë prishën edhe rreshtin për t'ju afruar sa më pranë shokut Mehmet Shehu dhe shokëve të tjerë që e shoqëronin. Ju desh edhe një herë komandantëve të jepnin komandat për të vënë rregull.

Mbasi ju paraqit forca shokut Mehmet Shehu, ai i përshëndeti partizanët, i përgëzoi për sukseset e luftës dhe të punës së tyre, u solli fjalët më të ngrohta të popullit, të partisë, të shokut Enver Hoxha.

Fjalët e shokut Mehmet Shehu u ndërprejnë shpeshherë me brohoritje të forta. Mbas ceremonisë në fushë u bë manifestimi. Kudo ziente kënga e vallja. Aty këtu këmbehej dhe ndonjë fjalë me shoku-shokun.

— E more vesh çfarë tha për brigadën tonë? — ju drejtua Ismaili një shoku që kishte ardhur nga Brigada XXV.

— Po, — ju përgjegy ai, — shoku Mehmet foli për gjithë partizanët që kanë luftuar në Jugosllavi.

Ne të gjithë e ndjemë se kemi bërë detyrën tonë ndaj shtetit tonë dhe popullit jugosllav.

Shoku Mehmet do të largohet. Partizanët i uruan atij rrugë të mbarë, duke tundur dikush pushkën, dikush duart dhe dikush shamitë e kuqe.

Takimi i shokut Mehmet Shehu pati jehonë të madhe. Partizanët u armatosën me energji të reja, fjalët e tij të zjarra kishin ngrohur zemrat e secilit.

KTHIMI NË ATDHE

Partizanët qëndruan mjaft në Dibër. Kohën e kalonin me përgatitje të gjithanshme, por nuk mundonin të shkonin ndonjëherë edhe në ndjekje, në drejtim të pyllit Jama ose në ndonjë drejtim tjetër për të asgjësuar ndonjë bandë diversantësh.

Më 2 dhjetor të vitit 1945 brigada votoi 100 për qind për kandidatët e Frontit Demokratik të Shqipërisë. Sa gjallëri u pa ato ditë në fytyrat e partizanëve!

Kur erdhi lajmi në Dibër se divizioni do të kthehej në atdhe filloi një gjallëri edhe më e madhe. Të gjithë i kishte marrë malli për vendin e tyre, për prindërit, për vëllezërit dhe për motrat.

Dikush mendonte të takonte babanë dhe njerëzit e tij atje larg në fshat, dikush do të takohej me nënën e tij atje te muret e qytetit të Beratit, dikush do të takonte motrën. Kishte dhe nga ata që për më tepër se dy vjet luftë nuk ishin takuar me gruan dhe fëmijët e tyre.

Më të mërzhitur atë ditë ishin Ibrahim (vullnetari kosovar) dhe shokët e tij. Atyre nuk u vinte

mirë që po ndaheshin nga ne, nga ushtria shqiptare. Ata nuk kishin besim në ato që thuheshin për çështjen kosovare, për Kosovën, për shkollat.

Megjithatë Ibrahimin me shokë e mbante një shpresë se çështja kosovare do të zgjidhej dhe se ata do të shiheshin përsëri të bashkuar për ndërtimin e socializmit e të komunizmit.

Partizanët do të largoheshin.

— Rrugë të mbarë, rrugë të mbarë e mirë u pafshim! — u uronin partizanëve vullnetarët kosovarë, duke u përqaftuar me njeri-tjetrin.

Kaluan lumin Drin dhe ju afruan Klenjës. Me të kaluar kufirin partizanët filluan të ecnin me aq shpejtësi saqë formacioni i rreshtimit u prish fare. Në Librazhd të gjithë partizanët u bashkuan dhe ecnin në të dyja anët e rrugës me rregull të plotë drejt Elbasanit.

Qytetarët e Elbasanit kishin dalë disa kilometra larg, deri në Krastë për të pritur bijtë e tij që kryen me nder dhe lavdi detyrën që u ngarkoi partia dhe populli në luftën e madhe përtej kufirit.

Duke u larguar nga toka jugosllave partizanët lanë atje kujtimet më të mira, lanë gjakun dhe djersën e tyre. Vetëm nga Brigada VII sulmuese mbetën 77 të vrarë dhe midis tyre shtatë komisarë.

Populli jugosllav nuk do të harrojë ndihmën që i ka dhënë populli shqiptar në ditët më të vështira, nuk do të harrojë luftën heroike që bënë shtatë brigadat shqiptare në tokat jugosllave, nuk do të harrojë gjakun e 350 dëshmorëve tanë që ranë përtej kufirit. Ai nuk do të harrojë sakrificat e panumërta që bënë partizanët tanë gjatë qëndrimit për më tepër se një vit përtej kufirit.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

	Faqe
Qyteti i fundit u çlirua	5
Partizani malazez	13
Anglezët	20
Skënder Libohova	26
Në një natë bien tre komisarë	34
Pushimi i shkurtër	44
Marshim i vështirë	52
Plaku dhe Picirruku	59
Maja e Suhagorës dhe komisar Fari Zaimi	64
Bashkëveprimi	72
Drejt Berlinit	77
Sulmi i fundit	82
Në prapavijë të armikut	94
Në qytetin Rudo	99
Në Kosovë	105
Vullnetari kosovar	110
Kolë Myzeqari	115
Takim i përzemërt	121
Kthimi në atdhe	124

BIBLIOTEKA E SHËTËTIT
GJIROKASTER

54780

Tirazhi 3000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-65

Shtyp NISH Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë, 1971